Publikationen
zur rechtlichen Zusammenarbeit

Buletini i praktikës gjyqësore të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut

Botimi 2/2017, vëllimi i 5-të, viti i 3-të



botuar nga
Enti për përfaqësim të Republikës së Maqedonisë para GJEPD
dhe
Fondacioni gjerman për bashkëpunim ndërkombëtarë juridik, Shoqatë e regjistruar (IRZ)

IRZ

german cooperation
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Republic of Macedonia
Ministry of Justice
Republika e Maqedonisë
Ministria e Drejtësisë

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Botues:

MAKAVEJ Shkup, viti 2017

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Koço Bendo (faqe 10-47)

Behar Dalipi (faqe 48-77)

Koordinimi i redaksisë së botimit në gjuhën shqipe: Dr. Stefan Pürner, avokat, dhe Danica Djonova, v.d. Drejtore e Entit për përfaqësimin e RM-së para GJEDNJ-së.

Bashkëpunimi i redaksisë së botimit në gjuhën shqipe: Dragana Radisavlleviq, juriste e diplomuar me provimin e dhënë të judikaturës dhe Dana Trajçev – Bozhiq, V.A., studime për media dhe komunikime.

Përkthimi i këtij Buletini në gjuhën shqipe, si dhe botimi i këtij publikimi u mundësua nga ana e Fondacionit gjerman për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar, shoqatë e regjistruar (IRZ).

Buletini i praktikës gjyqësore të
Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut

botuar nga
Enti për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë para GJEDNJ-së

dhe
Fondacioni gjerman për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar
Shoqatë e regjistruar (IRZ)

Botimi 2/ 2017, vëllimi i 5-të, viti i 3-të, në gjuhën shqipe

~~~~~~~~~~~~~~~~

Newsletter zur Rechtsprechung des
Europäischen Gerichtshofs für Menschenrechte

Gemeinsam herausgegeben von dem mazedonischen
Regierungsvertreter vor dem EGMR

und der
Deutschen Stiftung für internationale rechtliche
Zusammenarbeit e.V. (IRZ)

Ausgabe 2/2017, 5. Band, 3. Jahrgang in albanischer Sprache
~~~~~~~~~~~~~~~~

Sehr geehrte Kolleginnen und Kollegen, liebe Leser,

sie halten eine neue Ausgabe des bereits im dritten Jahr erscheinenden Newsletter zur Rechtsprechung des Europäischen Gerichtshofs für Menschenrechte (EGMR) in Straßburg in Händen. Dieser Newsletter ist zur Information von Justizangehörigen, insbesondere Richtern und Staatsanwälten, und Behördenmitarbeitern in Mazedonien gedacht. Deshalb berichtet er vor allem über Urteile des Straßburger Gerichts, die für diese von besonderem Interesse sind, also über Entscheidungen, die gegen Mazedonien ergangen sind, oder aber, obwohl sie aus Verfahren gegen andere Staaten stammen, sich auf Rechtsfragen beziehen, die in Mazedonien große praktische Bedeutung haben.

Herausgegeben wird dieser Newsletter, der in mazedonischer und albanischer Sprache erscheint, gemeinsam von der mazedonischen Regierungsvertreterin und Direktorin des Büros für die Vertretung Mazedoniens vor dem EGMR und der Deutschen Stiftung für internationale rechtliche Zusammenarbeit e.V. (kurz IRZ).

Bei der IRZ handelt es sich um eine seit 1992 bestehende Organisation, die im Auftrag der deutschen Bundesregierung Transformationsstaaten bei den Reformen hin zum Rechtstaat unterstützt. In der IRZ sind die wichtigsten deutschen Organisationen, die im Bereich des Rechtsstaates und der Justiz tätig sind, zusammengeschlossen. Dazu gehören (in alphabetischer Reihenfolge gemäß ihrer Bezeichnung in deutscher Sprache) der Bund Deutscher Rechtspfleger e.V., der Bund Deutscher Verwaltungsrichter und Verwaltungsrichterinnen, die Bundesnotarkammer, die Bundesrechtsanwaltskammer, der Deutsche Anwaltverein e.V., die Deutsche Institution für Schiedsgerichtsbarkeit e.V., der Deutsche Juristinnenbund e.V. der Deutsche Notarverein e.V., der Deutsche Richterbund e.V. und die Notarkammer Koblenz.

Eine weitere Gruppe von Mitgliedern bilden wirtschaftliche Vereinigungen, wie der Bundesverband der Deutschen Industrie e.V., der Bundesverband deutscher Banken e.V., der Bundesverband der Unternehmensjuristen e.V., der Deutsche Genossenschafts- und Raiffeisenverband e.V., der Deutsche Industrie- und Handelskammertag e.V., der Gesamtverband der Deutschen Versicherungswirtschaft e.V., der Markenverband e.V., Berlin und der Osteuropaverein der deutschen Wirtschaft e. V.

Hinzu kommen bedeutende Industrieunternehmen Allianz SE, Bayer AG und Daimler AG) sowie eine Anzahl von Einzelpersonen aus Justiz, Politik und Wissenschaft.

In Mazedonien ist die IRZ seit dem Jahr 2000 mit Mitteln des deutschen Auswärtigen Amtes (AA) aus dem deutschen Beitrag zum Stabilitätspakt für Südosteuropa tätig. Darüber hinaus wird die Tätigkeit der IRZ allgemein, aber auch in Südosteuropa, durch eine

Shumë të nderuar kolege dhe kolegë, të dashur lexues,

po merrni në dorë botimin e ri të buletinit në vitin e tij të tretë të publikimit mbi praktikën gjyqësore të Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg. Ky buletin është menduar për informimin e operatorëve të drejtësisë, veçanërisht gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe punonjësve të organeve administrative në Maqedoni. Për këtë arsye ai përmban para së gjithash vendime të Gjykatës së Strasburgut që për ta paraqesin interes të veçantë, pra vendime të cilat janë dhënë kundër Maqedonisë ose nga gjykime të tjera kundër shteteve të tjera, por që prekin çështje ligjore të cilat për Maqedoninë janë me rëndësi të madhe praktike.

Ky buletin, i cili del në gjuhët maqedonase dhe shqipe, botohet në bashkëpunim me përfaqësuesen e qeverisë maqedonase dhe Drejtorinë e Agjencisë për përfaqësimin e Maqedonisë para GJEDNJ-së dhe Fondacionit Gjerman për Bashkëpunim ligjor ndërkombëtar (shkurt IRZ).

IRZ-ja është një organizatë që është themeluar në vitin 1992, e cila, në emër të Qeverisë Federale Gjermane, mbështet shtetet në transformim e sipër në reformat e tyre drejt shtetit të së drejtës. Në IRZ-ë përfaqësohen organizatat gjermane më të rëndësishme të cilat veprojnë në sferën e shtetit të së drejtës dhe drejtësisë. Këtu përfshihen (në renditje alfabetike sipas emërtimit në gjuhën gjermane) Lidhja Gjermane e Punonjësve Gjyqësorë (der Bund Deutscher Rechtspfleger e.V.), Lidhja Gjermane e Gjyqtarëve dhe Gjyqtareve për Çështjet Administrative (der Bund Deutscher Verwaltungsrichter und Verwaltungsrichterinnen), Dhoma Federale e Noterisë (die Bundesnotarkammer), Dhoma Federale e Avokatisë (die Bundesrechtsanwaltskammer), Shoqata Gjermane e Avokatëve (der Deutsche Anwaltverein e.V.), Institucioni gjerman i Arbitrazhit (die Deutsche Institution für Schiedsgerichtsbarkeit e.V.), Lidhja gjermane e Juristëve (der Deutsche Juristinnenbund e.V.), Shoqata Gjermane e Noterëve (der Deutsche Notarverein e.V.), Lidhja Gjermane e Gjyqtarëve (der Deutsche Richterbund e.V.) dhe Dhoma e Noterisë Koblenz (die Notarkammer Koblenz).

Një grup tjetër i anëtarëve përbëhet nga organizimet ekonomike si Shoqata Federale e Industrisë Gjermane (der Bundesverband der Deutschen Industrie e.V.), Shoqata Federale e Bankave Gjermane (der Bundesverband deutscher Banken e.V.), Shoqata Federale e Juristëve të Ndërmarrjeve (der Bundesverband der Unternehmensjuristen e.V.), Shoqata Gjermane e Kooperativave dhe Raiffeisen-it (der Deutsche Genossenschafts- und Raiffeisenverband e.V.), Kongresi i Dhomës Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë (der Deutsche Industrie- und Handelskammertag e.V.), Shoqata e Përgjithshme e Ekonomisë Gjermane të Sigurimeve (der Gesamtverband der Deutschen Versicherungswirtschaft

institutionelle Zuwendung des deutschen Bundesministeriums der Justiz und für Verbraucherschutz (BMJV) ermöglicht.

Im Rahmen dieser Tätigkeit spielen die Menschenrechte und die Europäisierung des Rechtes eine besondere Rolle. Außer Gesetzgebungsberatung und Unterstützung bei der Aus- und Weiterbildung von Juristen arbeitet die IRZ auch auf dem besonders nachhaltigen Feld juristischer Publikationen. So erscheint in Mazedonien zusätzlich zu diesem Newsletter bereits seit dem Jahre 2011 eine juristische Fachzeitschrift zum Europarecht, die unter http://www.evropsko-pravo.info auch eine eigene Internetseite besitzt, von der alle bisher erschienene Ausgaben dieser Zeitschrift heruntergeladen werden können. Auch ist es dort möglich, einzelne Beiträge gezielt herunterzuladen.

Auch der vorliegende Newsletter wird in elektronischer Form vertrieben. So findet sich die mazedonische Fassung auf der Internetseite der IRZ unter https://www.irz.de/index.php/doënloads#публикации-на-македонски-јазик-publikationen-in-mazedonischer-sprache und die albanische unter

https://www.irz.de/index.php/doënloads#publikime-n%C3%AB-gjuh%C3%ABn-shqipe-publikationen-in-albanischer-sprache. Darüber hinaus werden alle Ausgaben des Newsletters auch auf der Internetseite des Büros für die Vertretung Mazedoniens vor dem EGMR unter http://biroescp.gov.mk in der Rublik „Sudska praksa" (Rechtsprechung) zum Herunterladen angeboten. Dort finden sich auch alle andere Urteile des EGMR gegen Mazedonien in mazedonischer Übersetzung.

Durch die elektronische Publikation wird der Newsletter allen Interessierten zugänglich. Die Angehörigen der mazedonischen Justiz erhalten ihn darüber hinaus in Druckform. Die wichtigste Rechtsprechung des EGMR ist deshalb mithilfe dieses Newsletters jedem mazedonischen Richter und Staatsanwalt zeitnah direkt auf seinem eigenen Schreibtisch zugänglich.

Die Herausgeber des Newsletters haben bewusst verschiedene Verbreitungswege gewählt, um einen möglichst großen Adressatenkreis erreichen zu können. Dies deshalb, da die Rechtsprechung des Straßburger EGMR für die Anwendung des jeweiligen nationalen Rechts von erheblicher Bedeutung ist. Außerdem garantiert sie, dass die gemeinsamen Menschenrechtsstandards der im Europarat zusammengeschlossenen Staaten auch in der Praxis tatsächlich eingehalten werden.

Ein so anspruchsvolles und nachhaltiges Unternehmen wie die bereits jahrelange regelmäßige Herausgabe eines aktuellen Newsletters in zwei Sprachen ist nur durch das Engagement aller Beteiligten, Teamwork und dauerhafte Unterstützung möglich.

e.V.), Shoqata e Markave, Berlin (der Markenverband e.V., Berlin) dhe Shoqata e Europës Lindore e Ekonomisë Gjermane (der Osteuropaverein der deutschen Wirtschaft e. V.).

Këtu përfshihen edhe ndërmarrjet e rëndësishme industriale Allianz SE, Bayer AG dhe Daimler AG si dhe një numër personalitetesh nga drejtësia, politika dhe shkenca.

Në Maqedoni IRZ-ja e ka filluar aktivitetin e saj në vitin 2000 me fondet e Ministrisë gjermane të Punëve të Jashtme nga kontributi gjerman për Paktin e Stabilitetit për Europën Juglindore. Përveç kësaj, aktiviteti i IRZ-së në përgjithësi, por edhe për Europën Juglindore, mundësohet nëpërmjet një kontributi institucional të Ministrisë Federale gjermane të Drejtësisë dhe për Mbrojtjen e Konsumatorit (MFDK).

Në kuadrin e këtij aktiviteti të drejtat e njeriut dhe europianizimi i së drejtës luajnë një rol të veçantë. Përveç këshillimeve në hartimin e legjislacionit dhe mbështetjes në trajnimin fillestar dhe të vazhduar të juristëve, IRZ-ja punon veçanërisht në sferën qëndrueshme të publikimeve juridike. Kështu në Maqedoni, përveç këtij buletini qysh nga viti 2011 botohet edhe një revistë juridike mbi të drejtën europiane e cila tek adresa http://www.evropsko-pravo.info ka edhe një faqe të vetën, nga e cila mund të shkarkohen të gjitha botimet e deritanishme të kësaj reviste. Edhe atje është e mundur të shkarkohen artikuj të veçantë.

Edhe ky buletin do të botohet në format elektronik. Kështu versioni në maqedonisht gjendet në faqen e internetit të IRZ-së tek adresa https://www.irz.de/index.php/doënloads#публикации-на-македонски-јазик-publikationen-in-mazedonischer-sprache dhe versioni në shqip tek adresa

https://www.irz.de/index.php/doënloads#publikime-n%C3%AB-gjuh%C3%ABn-shqipe-publikationen-in-albanischer-sprache. Përveç kësaj, të gjitha botimet e buletinit ofrohen për tu shkarkuar edhe në faqen e internetit të Agjencisë për përfaqësimin e Maqedonisë para GJEDNJ-së tek adresa http://biroescp.gov.mk në rubrikën „Sudska praksa" (Praktika gjyqësore). Atje gjenden edhe të gjitha vendimet e tjera të GJEDNJ-së kundër Maqedonisë të përkthyera në maqedonisht.

Nëpërmjet botimit elektronik buletini është i aksesueshëm nga të gjithë të interesuarit. Operatorëve të drejtësisë maqedonase ai u jepet edhe në format fizik. Nëpërmjet këtij buletini i vihet në dispozicion çdo gjyqtari dhe prokurori maqedonas praktika më e rëndësishme e GJEDNJ-së në kohë të afërt dhe drejtpërdrejt në tavolinën e tij të punës.

Botuesit e buletinit kanë zgjedhur në mënyrë të ndërgjegjshme disa variante publikimi, për të arritur një rreth sa më të gjerë të interesuarish. Kjo për shkak se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së së Strasburgut është e një rëndësie të veçantë për zbatimin e së drejtës

Allen voran gilt es dem deutschen Auswärtigen Amt für die finanzielle Unterstützung, ohne die die Publikation, die sie derzeit in Händen halten, nicht entstehen hätte können, zu danken. Ergänzt wird diese Unterstützung aus Berlin durch das Engagement der deutschen Botschaft vor Ort in Skopje, die die Tätigkeit der IRZ aktiv und engagiert begleitet. Deshalb gilt Herrn Botschafter Thomas Gerberich und seinen Mitarbeitern an dieser Stelle ein herzliches Wort des Dankes. Zu danken haben die Herausgeber auch dem deutschen Ministerium der Justiz und für Verbraucherschutz (BMJV), das die Arbeit der IRZ mit einer institutionellen Zuwendung überhaupt erst ermöglicht.

Besonderen Dank schulden die Herausgeber den Übersetzern, die sich regelmäßig der nicht leichten Aufgabe stellen, die hier zusammengefassten anspruchsvollen juristischen Texte in die genannten Sprachen zu übertragen.

Desweiteren ist auch den Mitarbeitern, die in den beteiligten Organisationen an der Erstellung dieses Newsletters mitgewirkt haben, zu danken. Dies sind bei der IRZ Frau Dana Trajcev Bozic, die diese Publikation in Bonn als Projektmanagerin Bonn betreut und Frau Natascha Andreevska-Tomovska, die in Skopje vor Ort für die IRZ die Koordination mit dem Projektpartner, den Übersetzern und dem Verlag übernommen hat.

Zuallerletzt ist noch den Lesern zu danken, die durch ihr bereits seit Jahren anhaltendes Interesse dazu beigetragen haben, dass dieser Newsletter ein Erfolg wurde. Diese Anerkennung ist uns Ansporn, die Herausgabe diese Publikation auch in Zukunft in der bisherigen Qualität fortzusetzen.

Bonn/Skopje, im November 2017

Danica Djonova LL.M
Kommissarische Direktorin des Büros
für die Vertretung Mazedoniens
vor dem EGMR

Rechtsanwalt Dr. Stefan Pürner
Bereichsleiter der IRZ
für Bosnien und Herzegowina, Mazedonien,
Montenegro sowie Serbien

përkatëse të brendshme. Përveç kësaj, ajo garanton që standardet e përbashkëta të të drejtave themelore të shteteve palë në Këshillin e Europës të respektohen faktikisht edhe ne praktikë.

Një ndërmarrje e tillë ambicioze dhe e qëndrueshme siç është botimi i rregullt për vite me radhë e një buletini të përditësuar në dy gjuhë është e mundur vetëm nëpërmjet angazhimit të të gjithë pjesëmarrësve, punës në ekip dhe mbështetjes së vazhdueshme.

Para së gjithash i duhen shprehur falënderimet Ministrisë gjermane të Punëve të Jashtme për mbështetjen financiare, pa të cilin botimi, të cilin tashme keni në dorë, nuk do të ishte i mundur. Kjo mbështetje nga Berlini plotësohet me angazhimin e ambasadës gjermane në Shkup, e cila ndjek në mënyrë të angazhuar dhe aktivisht aktivitetin e IRZ-së. Për këtë shkak Zotit Ambasador Thomas Gerberich dhe kolegëve të tij me këtë rast i shprehim falënderime të përzemërta. Botuesit duhet të falënderojnë gjithashtu edhe Ministrinë gjermane të Drejtësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MFDK), e cila ka mundësuar punën e IRZ-së nëpërmjet një kontributi institucional.

Një falënderim të veçantë botuesit duhet tu shprehin përkthyesve, të cilët marrin përsipër një punë jo të lehtë për përkthimin në gjuhët përkatëse të këtyre teksteve të vështira juridike të përmbledhura .

Më tej një falënderim u shkon edhe kolegëve, të cilët kanë kontribuar në kuadrin e organizatave pjesëmarrësve për përpilimin e këtij buletini. Këta janë në IRZ-ë Zj Dana Trajcev Bozic, e cila është kujdesur për këtë botim në Bon si menaxhere projekti dhe Zj Nataza Andreevska-Tomovska, e cila ka marrë përsipër në Shkup për IRZ-në bashkërendimin me partnerët e projektit, përkthyesit dhe shtëpinë botuese.

Pikë së fundi, një falënderim shkon për lexuesit të cilët, për vite me radhë nëpërmjet interesit të tyre kanë kontribuar që ky buletin të kthehet në sukses. Kjo mirënjohje është për ne nxitje për nxjerrjen e këtij botimi edhe në të ardhmen me cilësinë e deritanishme.

Bon/Shkup, nëntor 2017

Danica Djonova LL.M.
Drejtore e Komanduar e Agjencisë
për përfaqësimin e Maqedonisë
para GJEDNJ-së

Avokat Dr. Stefan Pürner
Drejtues i Projektit të IRZ-së
për Bosnjën dhe Hercegovinën, Maqedoninë
Malin e Zi dhe Serbinë.

Përmbajtja

Parathënia e botuesve 4

I. AKTGJYKIMET MË TË REJA TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Halime Kılıç kundër Turqisë - 63034/11, Vendimi 28.6.2016 (Seksioni II) 11

Buzadji kundër Republikës së Moldovës - 23755/07, Vendimi 5.7.2016 (GC) 13

Lazu kundër Republikës së Moldovës - 46182/08, Vendimi 5.7.2016 (Seksioni II) 15

Ziembiński kundër Polonisë (Nr. 2) - 1799/07, Vendimi 5.7.2016 (Seksioni IV) 17

Jørgensen dhe të tjerë kundër Danimarkës - 30173/12, Vendimi 28.6.2016 (Seksioni II) 19

Cindrić dhe Bešlić kundër Kroacisë - 72152/13, Vendimi 6.9.2016 (Seksioni II) 20

Muršić kundër Kroacisë, 7334/13, Vendimi 20.10.2016 (GC) 22

Vardanyan dhe Nanushyan kundër Armenisë , 8001/07, Vendimi 27.10.2016 (Seksioni I) .. 24

***Constantinides kundër Greqisë*,** 76438/12, Vendimi 6.10.2016 (Seksioni I) 26

***Saliba kundër Maltës*,** 24221/13, Vendimi 29.11.2016 (Seksioni IV) 28

***Grebneva dhe Alisimchik kundër Rusisë*,** 8918/05, Vendimi 22.11.2016 (Seksioni III) 30

***Magyar Helsinki Bizottság kundër Hungarisë*,** 18030/11, Vendimi 8.11.2016 (GC) 31

***A dhe B kundër Norvegjisë*,** 24130/11 dhe 29758/11, Vendimi 15.11.2016 (GC) 35

***Kutlu dhe të tjerë kundër Turqisë*,** 51861/11, Vendimi 13.12.2016 (Seksioni II) 37

***Béláné Nagy kundër Hungarisë*,** 53080/13, Vendimi 13.12.2016 (GC) 40

Khlaifia dhe të tjerë kundër Italisë, 16483/12, Vendimi 15.12.2016 (GC) 43

II. AKTGJYKIMET KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

***Kitanovska Stanojkoviq dhe të tjerë kundër Republikës së Maqedonisë*,**
A. nr. 2319/14, aktgjykimi i datës 13 tetor të vitit 2016 49

Selmani dhe të tjerët kundër Republikës së Maqedonisë – A. nr. 67259/14,
Aktgjykimi i GJEDNJ nga 9 shkurti i vitit 2017 54

***Karajanov kundër RM-së*,** A. nr. 2229/15,
aktgjykimi i GJEDNJ i datës 6 prill të vitit 2017. 70

I. AKTGJYKIMET MË TË REJA TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

NENI 2

Detyrimet pozitive (aspekti lëndor)

Vëmendje e pamjaftueshme kushtuar rrezikut të dëmtimeve fatale në kontekstin e dhunës në familje: *shkelje*

Halime Kılıç kundër Turqisë - 63034/11, Vendimi 28.6.2016 (Seksioni II)

Faktet - Fatma Babatli (e bija e kërkueses) bëri kallëzim penal duke pretenduar dhunë në familje dhe kërkuar masa mbrojtëse. Asaj i duhej ta përsëriste kërkesën disa herë pasi bashkëshorti i saj nuk i respektonte urdhrat dhe masat mbrojtëse që i jepeshin asaj. Pasi ai u kap në zotërim të thikave, ai u ndalua për pak kohë nga policia dhe më vonë u la i lirë. Disa muaj më vonë, e bija e kërkueses u vra nga bashkëshorti i saj, i cili pastaj vrau veten.

Ligji - Neni 2: Urdhrat dhe masat mbrojtëse dolën se ishin tërësisht jo-efektive, së pari për shkak të vonesave të tepërta në përmbushjen e tyre (19 ditë për urdhrin e parë dhe 8 javë për të dytin), dhe së dyti, pasi bashkëshorti i saj asnjë herë nuk ishte dënuar për shkak të mospërmbushjes së këtyre masave. Për më tepër, megjithë faktin që bashkëshorti i saj kishte demonstruar haptazi se përbënte një rrezik, gjykata penale refuzoi të përmbushte kërkesën e prokurorisë për ta vendosur ata në paraburgim, pa vlerësuar rreziqet për bashkëshorten e tij, duke përfshirë rrezikun e vdekjes ose sulmeve të tjera të mundshme. Klima e padënueshmërisë e krijuar në këtë mënyrë i mundësoi bashkëshortit të vazhdonte me sulmet e tij ndaj bashkëshortes pa patur frikë nga ndjekja penale. Në lidhje me mundësinë e pretenduar të viktimës për të kërkuar strehim në një strehë me shtatë fëmijët e saj, as prokurori dhe as policia nuk ishin përpjekur për ta orientuar

atë tek një institucion i përshtatshëm për nevojat e saj. Gjykata konstatoi që autoritetet e brendshme kishin patur për detyrë të merrnin parasysh situatën tepër delikate dhe të cenueshme psikologjike, fizike dhe materiale në të cilën ishte gjendur bashkëshortja dhe për ta vlerësuar atë përkatësisht, ndërsa duke i ofruar asaj mbështetjen e përshtatshme.

Përfundim: shkelje (njëzëri)

Neni 14 në lidhje me Nenin 2: Pas vendimit në çështjen Opuz kundër Turqisë - në të cilën Gjykata kishte konstatuar që dhuna në familje prekte kryesisht gratë dhe që pasiviteti i përgjithshëm dhe diskriminues i gjyqësorit në Turqi kishte krijuar një klimë që ishte inkurajuese për dhunën në familje - u morën shumë iniciativa në Turqi, siç ishte hyrja në fuqi e një ligji të ri që ofronte mbrojtje më të madhe (Ligji nr 6284) dhe ratifikimi i Konventës së Stambollit. Megjithatë, faktet e kësaj çështjeje ishin para datës së reformave. Duke iu referuar raporteve nga OJQ-ja Human Rights Watch dhe Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) dhe duke dhënë shifra mbi numrat e grave që kishin humbur jetën si rezultat i sulmeve, kërkuesja kishte dhënë prova prima facie që në momentin përkatës gratë nuk kishin marrë mbrojtjen e efektshme ndaj sulmeve. Nën dritën e këtyre raporteve dhe statistikave, Gjykata kishte qenë në gjendje të vëzhgonte gamën dhe vazhdimësinë e dhunës ndaj grave, veçanërisht dhunën në familje, në shoqërinë turke, si dhe faktin që numri i strehëve për gratë, në momentin përkatës, konsiderohej i pamjaftueshëm. Konstatimi i mësipërm i padënueshmërisë reflektonte një lloj mohimi nga ana e autoriteteve të brendshme, si në lidhje me rëndësinë e rasteve të dhunës në familje ashtu edhe pacenueshmërinë e veçantë të viktimave. Duke iu drejtuar veshin e shurdhër akteve të përsëritura të dhunës dhe kërcënimeve me vdekje ndaj së bijës së kërkueses, autoritetet e brendshme kishin krijuar një klimë që ishte nxitëse për dhunën në familje. Ishte e papranueshme që viktima ishte lënë të përballej me dhunën e bashkëshortit të saj pa burime apo mbrojtje.

Përfundim: shkelje (njëzëri)

Neni 41; 65,000 EUR në lidhje me dëmin jo-financiar.

Neni 5, par 3

Arsyeshmëria e paraburgimit

Mungesa e shkaqeve përkatëse dhe të mjaftueshme për paraburgim përveç dyshimit të arsyeshëm të kryerjes së një vepre penale: *shkelje*

Buzadji kundër Republikës së Moldovës - 23755/07**,** Vendimi 5.7.2016 (GC)

Faktet- Kërkuesi, një biznesmen, u arrestua në maj të vitit 2007 dhe u akuzua formalisht për mashtrimin e një shoqërie shtetërore drejtori i së cilës ai ishte. Ai u fut në paraburgim në pritje të gjykimit duke patur parasysh rëndësinë e akuzave ndaj tij, kompleksitetin e çështjes dhe rrezikun e fshehjes së provave. Paraburgimi i tij u zgjat disa herë deri në korrik 2007, kur gjykatat e brendshme e pranuan kërkesën e tij për tu vendosur në arrest shtëpie. Ai qëndroi në arrest shtëpie deri në mars 2008, kur ai u lirua përkundrejt garancisë. Në vendimin e Dhomës të datës 16 dhjetor 2014, Gjykata ishte e mendimit, bazuar në katër vota përkundrejt dy, që ka patur një shkelje të Nenit 5, par 3, të Konventës pasi gjykatat e brendshme nuk kishin dhënë shkaqe të mjaftueshme për zgjatjen e paraburgimit të kërkuesit në pritje të gjykimit dhe më vonë për urdhërimin e arrestit në shtëpi. Më 20 prill 2015, çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të Qeverisë moldave.

Ligji – Neni 5 par 3: Sipas pjesës së parë të Nenit 5, par 3, personat e arrestuar ose të ndaluar sipas Nenit 5, par 1 (c), si të dyshuar për kryerjen e një vepre penale kanë të drejtë të nxirren 'menjëherë' para një autoriteti gjyqësor i cili do të shqyrtojë ligjshmërinë e ndalimit dhe nëse dyshimi është i arsyeshëm. Sipas pjesës së dytë të Nenit 5, par 3 - e drejta për tu gjykuar brenda një afati të arsyeshëm ose liruar në pritje të gjykimit - praktika gjyqësore e Gjykatës ka theksuar që ekzistenca e një dyshimi të arsyeshëm është një kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimit të ndalimit, por, pas 'një kalimi të caktuar kohe', kjo nuk është e mjaftueshme, kështu që kërkohen shkaqe të tjera 'përkatëse dhe të mjaftueshme' për ndalimin. Megjithatë, Gjykata asnjëherë nuk e ka përcaktuar kohëzgjatjen e një 'kalimi të caktuar kohe', megjithëse ajo ka theksuar që kjo mund të jetë jo më shumë se disa ditë. Kështu, Gjykata e ka konsideruar të dobishme ta zhvillojë më tej praktikën e vet gjyqësore në

lidhje me kërkesën për autoritetet gjyqësore të brendshme për të arsyetuar vazhdimin e ndalimit për qëllimet e pjesës së dytë të Nenit 5, par 3. Si pikë fillimi, ajo ka përsëritur që periudha për tu marrë parasysh për vlerësimin e arsyeshmërisë së paraburgimit sipas pjesës së dytë fillon kur personit i është hequr liria e tij ose e saj. Gjykata vuri re që, ndërsa të dyja pjesët japin të drejta ligjore të qarta, ka patur disa mbivendosje: afati ka filluar të ecë për të dyja nga momenti i arrestit; të dyja kërkojnë që një autoritet gjyqësor të përcaktojë nëse ekzistojnë shkaqet që legjitimojnë paraburgimin dhe, në të kundërt, të urdhërojë lirimin; dhe në praktikë aplikimi i garancive sipas pjesës së dytë deri në një farë mase do të mbivendosej me ato të së parës, çka është tipike në situatat ku autoriteti gjyqësor që autorizon paraburgimin sipas pjesës së parë në të njëjtën kohë urdhëron paraburgimin duke iu nënshtruar garancive sipas së dytës. Në situata të tilla, paraqitja e parë e të dyshuarit para gjyqtarit përbën 'udhëkryqin' ku takohen të dy llojet e garancive dhe ku lloji i dytë pason të parin. Megjithatë, çështja se kur e dyta zbatohet në masë të plotë, në kuptimin që kërkohen shkaqet përkatëse dhe të plota përveç dyshimit të arsyeshëm, iu la të varej më shumë nga koncepti i paqartë i 'kalimit të një fare kohe'. Në këtë kuptim, Gjykata ka vënë re që ligjet e brendshme të pjesës më të madhe të tridhjetë e një Shteteve Anëtare të Këshillit të Europës të mbuluara nga anketa krahasimore e ligjeve kërkonin që autoritetet përkatës gjyqësorë të japin shkaqet 'përkatëse dhe të mjaftueshme' për vazhdimin e paraburgimit, që nëse nuk bëhet menjëherë vetëm disa ditë më vonë pas arrestit, që është kur një gjyqtar ka shqyrtuar për herë të parë domosdoshmërinë e vendosjes së personit të dyshuar në paraburgim. Një qasje e tillë, nëse është transpozuar nga Neni 5, par 3, i Konventës, jo vetëm do të thjeshtonte dhe do të sillte më shumë qartësi në praktikën gjyqësore të Konventës, por gjithashtu do të fuqizonte mbrojtjen ndaj paraburgimit tej një afati të arsyeshëm. Kështu kishte argumente detyruese për sinkronizimin e garancive të pjesës së dytë me pjesën e parë. Për pasojë, kërkesa që nëpunësi gjyqësor të japë shkaqet përkatëse dhe të mjaftueshme për ndalimin përveç ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm të zbatuar në momentin e vendimit të parë që urdhëron paraburgimin, që do të thotë 'menjëherë' pas arrestit. Dhoma e Madhe konstatoi që arresti i shtëpisë për kërkuesin përbënte gjithashtu heqje lirie dhe procedoi me

zbatimin e të njëjtëve kritere për të gjithë periudhën e heqjes së lirisë, pavarësisht vendit ku kërkuesi ishte ndaluar. Ajo konstatoi që shkaqet që u ngritën nga gjykatat e brendshme për urdhërimin dhe zgjatjen e ndalimit të kërkuesit kishin qenë të stereotipizuara dhe abstrakte. Vendimi i tyre kishte cituar shkaqet e ndalimit pa bërë përpjekje për të treguar si ato e kishin zbatuar në rrethanat konkrete të çështjes së kërkuesit. Për më tepër, gjykatat e brendshme nuk mund të thuhej që kishin vepruar në mënyrë konsistente. Veçanërisht, në disa raste ato i kishin rrëzuar pretendimet e prokurorit si të paarsyetuara dhe të pabaza në lidhje me rrezikun e arratisjes së kërkuesit, ndikimit të dëshmitarëve dhe manipulimit të provave. Në raste të tjera, ato kishin pranuar të njëjtat arsye ndërsa nuk kishte ndodhur ndonjë ndryshim i dukshëm në rrethanat dhe pa shpjegim. Kur bëhet fjalë për një çështje të rëndësishme si e drejta e lirisë, u takon autoriteteve të brendshme të demonstrojnë në mënyrë bindëse që ndalimi ka qenë i nevojshëm. Në këtë rast një gjë e tillë përjashtohet absolutisht. Kështu, nuk ka patur shkaqe përkatëse dhe të mjaftueshme për të urdhëruar dhe zgjatur ndalimin e kërkuesit në pritje të gjykimit.

Përfundim: shkelje (njëzëri)

Neni 41: 3,000 EUR në lidhje me dëmin financiar.

NENI 6

Neni 6, par 1, (penale)

Gjykimi i drejtë Vendim i gjykatës së apelit për prishjen e pafajësisë së kërkuesit pa dëgjuar dëshmitë gojore nga dëshmitarët kryesorë të prokurorisë: *shkelje*

Lazu kundër Republikës së Moldovës - 46182/08, Vendimi 5.7.2016 (Seksioni II)

Faktet - Në vitin 2005, kërkuesi, shofer i një automjeti të blinduar banke, u akuzua për shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor. Ai u shpall i pafajshëm

nga gjykata e shkallës së parë për shkak se deklarimet e dëshmitarit ndaj tij nuk mund të konsideroheshin të besueshme. Megjithatë, ai më vonë u dënua nga gjykata e apelit. Në kërkesën e tij drejtuar Gjykatës Europiane, kërkuesi u ankua që procedimi penal ndaj tij nuk kishte qenë i drejtë pasi, në rastin e prishjes së pafajësisë së tij, gjykata e apelit nuk i kishte dëgjuar dëshmitarët dëshmia e të cilëve ishte përdorur për ta fajësuar atë, në shkelje të Nenit 6, par 1, të Konventës.

Ligji – Neni 6, par 1: Gjykata qysh në fillim vuri re që deklarimet e dëshmitarëve dhe rëndësia që u ishte dhënë atyre kishte patur një ndikim vendimtar mbi vendimmarrjen mbi çështjen, pasi, përveç tyre, nuk ka patur prova të tjera që nga ana e tyre do të sillnin dënimin e kërkuesit. Gjykata e shkallës së parë i dha pafajësi kërkuesit pasi ajo nuk i besoi dëshmitarët pasi i dëgjoi ata personalisht. Gjatë rishqyrtimit të çështjes, gjykata e apelit nuk ra dakord me gjykatën e shkallës së parë në lidhje me besueshmërinë e deklarimeve të dëshmitarëve pa i dëgjuar fare dëshmitarët. Si rezultat, ajo e shpalli kërkuesin me faj sipas akuzës. Duke e bërë këtë, gjykata e apelit ka shkelur dispozitat përkatëse ligjore si dhe interpretimin e tyre të bërë nga praktika gjyqësore e brendshme, që parashikon që, me qëllim që një gjykatë apeli të dalë më vendim themeli për një çështje, është e nevojshme një shqyrtim i ri i provave. Për më tepër, gjykata e apelit nuk ka dhënë asnjë shkak për mosrespektimin e ligjit të brendshëm, dhe as shpjegoi se pse kishte dalë me një përfundim të ndryshëm nga ai i gjykatës së shkallës së parë. Së fundmi, duke patur parasysh se për çfarë bëhej fjalë për kërkuesin, çështjet që duhet të vendoseshin nga gjykata e apelit nuk mund të shqyrtoheshin si duhet pa një vlerësim të drejtpërdrejtë të provave të dhëna nga dëshmitarët e prokurorisë. Në dosjen e çështjes nuk ndodhej asgjë që të tregonte se kërkuesi kishte hequr dorë nga e drejta e tij për të ri-thirrur ndonjë nga dëshmitarët të ndryshëm nga viktima. Për më tepër, duke marrë pafajësinë në shkallë të parë dhe duke qenë në dijeni që për të dhënë fajësi gjykata e apelit duhej të ri-vlerësonte drejtpërdrejt provat e dosjes, kërkuesi nuk kishte ndonjë arsye të veçantë të thërriste dëshmitarët. Fajësimi i kërkuesit pa ri-marrë në pyetje ndonjë prej dëshmitarëve, pasi ai kishte marrë pafajësi nga gjykata e shkallës së parë, kishte shkelur garancitë e një gjykimi të drejtë.

Përfundimi: shkelje (gjashtë vota me një)

Neni 41: 2 000 EURO në lidhje me dëmin jo-financiar; rrëzohet pretendimi në lidhje me dëmin financiar .

NENI 10

Liria e shprehjes

Dënim penal dhe caktimi i një gjobe për një gazetar për një artikull që vë në lojë nëpunësit e pushtetit lokal: *shkelje*

Ziembiński kundër Polonisë (Nr. 2) - 1799/07, Vendimi 5.7.2016 (Seksioni IV)

Faktet - Kërkuesi ishte pronari dhe kryeredaktor i një gazete lokale që publikoi një artikull i cili vinte në lojë një kryetar bashkie dhe dy nëpunës të tij për shkak të miratimit prej tyre të një projekti për të zhvilluar mbarështimin e shpendëve në një rajon si zgjidhje për problemin e papunësisë në fshat. Artikulli i etiketoi kryetarin e bashkisë dhe një prej nëpunësve 'bosa të mefshtë' dhe nëpunësin tjetër e përshkroi si 'budalla', 'të trashë' dhe 'i shtirur'. Kryetari i bashkisë dhe dy nëpunësit bënë kallëzim penal në prokurori kundër kërkuesit për shpifje. Duke e ri-kualifikuar veprën penale si një vepër që shkakton fyerje, gjykatat e brendshme e dënuan atë me një gjobë, duke konstatuar që ai kishte abuzuar me të drejtën e fjalës dhe kishte shkelur dinjitetin e nëpunësve.

Ligji – Neni 10: Dhënia e fajësisë dhe dënimi i kërkuesit kishte sjellë si pasojë 'ndërhyrjen' në ushtrimin e së drejtës së tij të shprehjes. Ishte e parashikuar me ligj dhe ishte ndjekur qëllimi legjitim i mbrojtjes së emrit dhe të drejtave të të tjerëve. Kërkuesi kishte shkruar një artikull satirik duke kritikuar projektin e mbarështimit të shpendëve të miratuar nga nëpunësit lokalë si një zgjidhje për problemin e papunësisë lokale. Nuk kishte dyshim që kjo çështje, që kishte të bënte me ushtrimin e funksioneve të nëpunësve lokalë, kishte qenë një çështje e interesit të ligjshëm publik dhe në këtë mënyrë prekte

një sferë në të cilën kufizimet e lirisë së shprehjes duhej të interpretoheshin në mënyrë rigoroze. Kërkuesi u fajësua për shprehjen e ofendimeve ndaj nëpunësve të pushtetit lokal, duke përfshirë kryetarin e bashkisë, i cili, si një politikan lokal i zgjedhur, mund ti nënshtrohej një kritike më të gjerë se individët privatë. Dy nëpunësit e tjerë ishin punonjës të shërbimit civil. Ndërsa punonjësit e shërbimit civil në cilësinë e tyre zyrtare, ashtu si politikanët, i nënshtroheshin një game më të gjerë kritike se sa individët privatë, nuk mund të thuhet që ata në mënyrë të ndërgjegjshme janë të hapur ndaj kontrollit të imët në lidhje me çdo fjalë dhe veprim në masën që janë politikanët. Vlerësimi i domosdoshmërisë së ndërhyrjes në çështjen në fjalë nuk mund të veçohej nga konteksti dhe qëllimi i dukshëm i kritikës së kërkuesit. Natyra satirike e tekstit dhe ironia brenda tij duhej të merreshin parasysh në analizën e artikullit. Përdorimi i sarkazmës dhe ironisë ishte në përputhje të plotë me ushtrimin e lirisë së shprehjes së gazetarit. Megjithatë, gjykatat e brendshme nuk i kishin marrë parasysh sa duhet këto tipare. Nuk kishte dyshim që shprehjet në fjalë, të marra në kontekstin konkret të artikullit, mbeteshin brenda kufijve të ekzagjerimit të pranueshëm. Gjykatat e brendshme nuk i kishin konsideruar ato në kontekstin e artikullit si një i tërë. Satira ishte një formë e shprehjes artistike të komentit social, i cili, nëpërmjet tipareve të veta të brendshme të ekzagjerimit dhe deformimit të realitetit, natyrisht që synonte provokimin dhe ngacmimin. Për pasojë, çdo ndërhyrje në të drejtën e përdorimit të këtij mjeti të shprehjes duhej të trajtohej me kujdes të veçantë. Së fundi, kërkuesi ishte dënuar me një gjobë prej 2 630 Euro dhe ishte urdhëruar të paguante shpenzimet në një shumë të përgjithshme prej 755 Euro. Duke patur parasysh konsideratat e mësipërme, gjykatat e brendshme nuk kishin dhënë arsyet 'përkatëse dhe të mjaftueshme' për të justifikuar fajësimin dhe dënimin e kërkuesit. Për pasojë, ndërhyrja tek e drejta e lirisë së shprehjes ishte jo-proporcionale me qëllimin e ndjekur dhe nuk kishte qenë e 'nevojshme në një shoqëri demokratike'.

Përfundimi: shkelje (pesë vota me dy)

Neni 41: 1 000 EURO në lidhje me dëmin jo-financiar; 3 385 Euro në lidhje me dëmin financiar.

NENI 35

Neni 35, par 1, Shterimi i mjeteve të brendshme

Afati gjashtë-mujor Kërkesa që pretendon shkeljen e Nenit 2 të Konventës e paraqitur brenda më pak se gjashtë muaj pas vendimit përfundimtar në çështjet civile por tej afatit gjashtë-mujor pas vendimit përfundimtar në çështjet penale: *i papranueshëm*

Jørgensen dhe të tjerë kundër Danimarkës - 30173/12, Vendimi 28.6.2016 (Seksioni II)

Faktet - Kërkuesi i parë dhe i dytë ishin të afërt të dy burrave që ishin vrarë në dhjetor të vitit 2001, ndërsa policia qëlloi mbi një automjet fuoristradë me të cilin ata udhëtonin. Policia deklaroi që kishte vepruar në vetë-mbrojtje pasi automjeti i tyre i patrullimit ishte goditur disa herë. Prokurori rajonal i shtetit filloi menjëherë hetimet penale në sjelljen e nëpunësve të policisë, por vendosi për të mos ushtruar ndjekje penale pasi konstatoi që nëpunësit kishin vepruar në vetë-mbrojtje të justifikuar. Vendimi i tij u la në fuqi nga Drejtori i Ndjekjes Penale (DNP) në shkurt 2005. Në dhjetor të vitit 2006, kërkuesit nisën çështje për kompensim para gjykatave civile. Pretendimet e tyre u refuzuan nga Gjykata e Lartë në një vendim që u la në fuqi nga Gjykata Supreme në nëntor 2011. Në gjykimin sipas Konventës, kërkuesit pretendonin një shkelje të Nenit 2 të Konventës. Kërkesa e tyre u depozitua në maj 2012, brenda afatit gjashtë-mujor të vendimit të gjykatës Supreme, por tej afatit gjashtë-mujor të vendimit të DNP-së. Qeveria parashtroi që kërkuesit nuk e kishin respektuar afatin gjashtë-mujor.

Ligji – Neni 35 par 1: Çështja thelbësore ishte nëse gjykimi pasues civil para gjykatave civile, që kishte juridiksion të plotë për të vendosur nëse ngjarjet objekt mosmarrëveshjeje dhe hetimi kanë qenë në pajtim me Nenet 2 dhe 3 të Konventës, ishin gjithashtu një mjet i efektshëm brenda kuptimit të Nenit 35, par 1, që kërkuesve u kërkohej ta ezauronin. Gjykata vuri re që raporti i Prokurorit Rajonal të Shtetit në lidhje me ngjarjet dhe vlerësimi i provave ishte mbikëqyrur si nga Bordi i Policisë për Ankesa dhe DNP-ja. As hetimi fillestar në ngarkim të nëpunësve të policisë dhe as hetimi i ri-hapur nuk kishte sjelle procedim penal ndaj tyre pasi u konstatua që ata

kishin vepruar në vetë-mbrojtje të justifikuar. Në këto rrethana, Gjykata nuk ishte e bindur që hapja në vijim e çështjes civile normalisht do të rriste mundësinë që gjykatat të konstatonin një shkelje të Nenit 2 të Konventës (gjë që do të kishte sjellë ri-hapje të hetimit dhe eventualisht një gjykim penal). Ajo gjithashtu vuri re që çështja civile u hap më vonë se dy vjet pas vendimit përfundimtar të DNP-së dhe që ndërkohë nuk ishte zbuluar ndonjë provë vendimtare, si dhe që Gjykata e Lartë dhe Gjykata Supreme kishin vendosur njëzëri kundër kërkuesve. Për pasojë, çështja civile pas vendimit përfundimtar të DNP-së nuk ishte një mjet që kërkonte shterim dhe kërkesa ishte bërë tej afatit.

Përfundim: e papranueshme (tej afatit).

NENI 1 I PROTOKOLLIT Nr. 1

Gëzimi paqësisht i sendeve në zotërim

Shpenzimet e urdhëruara në gjykimin civil bëhen shkak për barrë jo-proporcionale: *shkelje*

Cindrić dhe Bešlić kundër Kroacisë - 72152/13, Vendimi 6.9.2016 (Seksioni II)

Faktet - Në janar të vitit 1992, gjatë luftës në Kroaci, prindërit e kërkuesve ishim marrë me forcë nga banesa e tyre në pjesën e pushtuar të vendit nga dy burra dhe u qëlluan me armë për vdekje. Hetimi në lidhje me vdekjen e tyre nuk ka përfunduar. Kërkuesit ngritën padi civile në lidhje me vrasjet e tyre kundër Shtetit por pa sukses dhe u urdhëruan të paguanin shpenzimet në një shumë përafërsisht 6 800 EURO, gjë që sipas mendimit ë tyre shkelte të drejtën e tyre për gëzim paqësisht të sendeve në zotërim të tyre dhe të drejtën e tyre për akses në gjykatë.

Ligji - Neni 1 i Protokollit Nr. 1: Gjykata doli me përfundimin që urdhri për shpenzimet solli për pasojë një ndërhyrje në të drejtën e kërkuesit për gëzim paqësisht të sendeve në zotërim të tyre dhe që ndërhyrja kishte qenë

e ligjshme dhe kishte ndjekur një qëllim legjitim. Çështja kryesore ishte nëse ishte gjetur balanca e duhur ndërmjet interesit të përgjithshëm dhe të drejtës së kërkuesit sipas Nenit 1 të Protokollit nr. 1. Gjykata duhej të konstatonte nëse, për shkak të ndërhyrjes së Shtetit, kërkuesve u duhej të përballonin një barrë jo-proporcionale dhe te tepërt. Ishte pretenduar që prindërit e kërkuesve ishin rrëmbyer nga dy punonjës policie nga banesa e tyre në një fshat të pushtuar, ishin çuar në një fshat të afërt dhe ishin vrarë me armë, thjesht për shkak të origjinës së tyre etnike Kroate. Pretendimi civil ishte rrëzuar në tërësinë e vet për shkak se Shteti nuk ishte përgjegjës për dëmet që rezultonin nga vrasjet e kryera në territor që në momentin përkatës kishte qenë jashtë kontrollit të tij. Në këtë situatë, kërkuesit ishin urdhëruar të rimbursonin shpenzimet për përfaqësimin e shtetit nga Zyra e Avokatisë së Shtetit në një shumë të barabartë me atë të tarifës së një avokati. Nuk mund të thuhej që padia civile e kërkuesve ndaj shtetit ishte tërësisht pa shkak apo ishte haptazi e paarsyetuar. Mendimi i kërkuesve që dëmi i shkaktuar atyre nga vrasja e prindërve të tyre ishte i mbuluar nga legjislacioni përkatës dhe nuk ishte i paarsyeshëm, meqenëse në atë moment nuk ishte e mundur për ata të dinin se si do të interpretohej legjislacioni. Gjykata i kushtoi rëndësi të veçantë faktit që pala kundërshtare në gjykimin në fjalë ishte Shteti kroat, i përfaqësuar nga Zyra e Avokatisë së Shtetit dhe që shpenzimet e asaj zyre në gjykimin civil në fjalë ishin vlerësuar në bazë të tarifës së një avokati. Megjithatë, zyra, meqenëse ajo financohej nga buxheti i Shtetit, nuk ishte në të njëjtën pozitë si një avokat. Një faktor tjetër i rëndësishëm ishte ajo e situatës financiare individuale e kërkuesve. Gjykata pranoi që pagesa e shumës së urdhëruar nga gjykatat e brendshme dukej e rëndë për ta. Nën dritën e këtyre faktorëve, Gjykata doli me përfundimin që urdhërimi i kërkuesve të mbulonin të gjitha shpenzimet e përfaqësimit të shtetit në gjykimin në fjalë sillte një barrë jo-proporcionale për ta.

Përfundim: shkelje (njëzëri)

Gjykata doli njëzëri në përfundimin që ka patur një shkelje të Nenit 6, par 1, të Konventës (pasi ka patur një kufizim jo-proporcional të së drejtës së

kërkuesve për akses në gjykatë) dhe nuk ka patur shkelje të Nenit 2 (e drejta për jetën).

Neni 41: 5 000 EURO në lidhje me dëmin jo-financiar; 3 400 Euro në lidhje me dëmin financiar.

NENI 3

Trajtimi poshtërues Hapësira e kufizuar personale në sistemimin në burg në qeli për disa persona: *shkelje*

Muršić kundër Kroacisë, 7334/13, Vendimi 20.10.2016 (GC)

Faktet - Në kërkesën e tij për në Gjykatën Europiane, kërkuesi u ankua në lidhje me mungesën e hapësirës personale në burg që, sipas rastit, kishte qenë më pak se 3 metra katrorë. Në vendimin e datës 12 mars 2015, një Dhomë e Gjykatës, me gjashtë vota me një, konstatoi që nuk ka patur shkelje të Nenit 3 të Konventës. Veçanërisht, ajo konstatoi që kushtet e ndalimit të kërkuesit, megjithëse jo gjithmonë të përshtatshme, nuk e kishin arritur kufirin e ashpërsisë së kërkuar për të karakterizuar trajtimin si çnjerëzor ose poshtërues brenda kuptimit të Nenit 3. Më 7 korrik 2015, çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të kërkuesit.

Ligji – Neni 3: Vlerësimi i gjykatës në lidhje me faktin nëse ka patur shkelje të Nenit 3 nuk mund të përfundonte në një përllogaritje numerike në metra katrorë të caktuar për çdo të burgosur. Një qëndrim i tillë do të injoronte faktin që, në terma praktike, vetëm një trajtim i plotë për kushtet konkrete të ndalimit mund të sillte një pamje të saktë të realitetit për të burgosurit. Megjithatë, nëse hapësira personale e disponueshme për çdo të burgosur në sistemimin në burgjet me qeli për shumë persona bie poshtë 3 metrave katrorë sipërfaqe, mungesa e hapësirës personale u konsiderua kaq e ashpër sa lindi një prezumim i fortë për një shkelje të Nenit 3. Barra e provës i takonte Qeverisë si palë kundërshtare, e cila mund ta përmbyste këtë prezumim duke demonstruar që ka patur faktorë që mund të kompensojnë në mënyrë të përshtatshme pjesën e pakët të hapësirës personale. Prezumimi i fortë

i një shkeljeje normalisht mund të përmbyset vetëm nëse përmbushen në mënyrë shtuese faktorët e mëposhtëm: kufizimet në hapësirën e kërkuar minimale personale prej 3 metra katrorë ishin të shkurtra, rastësore dhe minimale; këto kufizime shoqëroheshin me lirinë e mjaftueshme të lëvizjes jashtë qelisë dhe aktivitetet e përshtatshme jashtë qelisë; kërkuesi ishte i ndaluar në atë që, parë në përgjithësi, ishte një mjedis i përshtatshëm ndalimi dhe nuk ka patur (Shënimi Informativ 200, tetor 2016, Neni 3, faqe 9) aspekte të tjera rënduese të kushteve të ndalimit të tij ose të saj. Në rastet kur bëhet fjalë për një qeli burgu në gamën brenda 3-4 metra katrorë për hapësirë personale për çdo të burgosur, hapësira mbetet një faktor me peshë në vlerësimin e Gjykatës në lidhje me përshtatshmërinë e kushteve të ndalimit. Në këto raste, një shkelje e Nenit 3 do të konstatohej nëse faktori i hapësirës shoqërohej me aspekte të tjera të kushteve të papërshtatshme fizike të ndalimit në lidhje me, veçanërisht, aksesin tek ushtrimet jashtë qelisë, dritën natyrore ose ajrimin, disponibilitetin e ventilimit, përshtatshmëria e temperaturës në qeli, mundësia e përdorimit të tualeteve jo në prani të të tjerëve, përputhshmëria me kërkesat bazë higjeno-sanitare. Në rastet kur një i ndaluar ka në dispozicion më pak se 4 metra katrorë si hapësirë personale në sistemimin në burg me qeli me shumë persona dhe nëse nuk del çështja në lidhje me hapësirën personale, aspektet e tjera të kushteve fizike të ndalimit mbeten të rëndësishme në vlerësimin e gjykatës në lidhje me përshtatshmërinë e kushteve të ndalimit të një kërkuesi. Kërkuesi ka patur raste që është ndaluar në qeli që ishin më pak se 3 metra katrorë dhe në këto kushte ka patur një prezumim të fortë për shkelje të Nenit 3. Në lidhje me një nga këto raste që ka zgjatur njëzet e shtatë ditë, prezumimi i fortë që ka patur shkelje nuk mund të vihet në dyshim. Kushtet e ndalimit të kërkuesit gjatë kësaj periudhe e kishin vënë atë në vështirësi tej nivelit të paevitueshëm të vuajtjes që shoqëron ndalimin dhe në këtë mënyrë ka çuar në një trajtim poshtërues të ndaluar nga Neni 3. Në lidhje me rastet e tjera gjatë të cilave kërkuesi ka patur në dispozicion më pak se 3 metra katrorë si hapësirë personale, Qeveria e kishte përmbysur prezumimin e fortë të shkeljes. Kërkuesi ishte mbajtur i ndaluar në kushte përgjithësisht të përshtatshme, periudhat jo të njëpasnjëshme mund të konsideroheshin si kufizim i shkurtër dhe i parëndësishëm i hapësirës personale, gjatë së cilës

atij i ishte ofruar liri e mjaftueshme e lëvizjes dhe aktivitete jashtë qelisë dhe, në këto rrethana, Gjykata konsideroi që këto periudha nuk përbënin shkak për trajtim poshtërues të ndaluar nga Neni 3 i Konventës. Kushtet e ndalimit të kërkuesit në periudhën kur ai kishte në dispozicion ndërmjet 3 dhe 4 metra katrorë si hapësirë personale nuk janë bërë shkak për trajtim çnjerëzor dhe poshtërues.

Përfundime: - shkelje në lidhje me periudhën prej njëzet e shtatë ditë gjatë së cilës kërkuesi kishte në dispozicion më pak se 3 metra katrorë hapësirë personale (njëzëri);

- nuk ka shkelje në lidhje me pjesën e mbetur të periudhave jo të njëpasnjëshme në të cilat kërkuesi kishte në dispozicion jo më pak se 3 metra katrorë hapësirë personale (dhjetë vota me shtatë);
- nuk ka shkelje në lidhje me periudhat në të cilat kërkuesi ka patur në dispozicion ndërmjet 3 dhe 4 metra katrorë hapësirë personale (trembëdhjetë me katër vota).

Neni 41: 1,000 EUR në lidhje me dëmin jo-financiar. (Shih gjithashtu Ananyev dhe të tjerë kundër Rusisë, 42525/07 dhe 60800/08, 10 janar 2012, Shënimi Informativ 148)

NENI 6

NENI 6, PAR 1, (CIVILE)

Gjykata e paanshme Vënia në dukje nga gjyqtari që refuzimi nga pala për të pranuar një zgjidhje me pajtim në gjykimin e brendshëm mund të ndikojë negativisht rezultatin: *shkelje*

Vardanyan dhe Nanushyan kundër Armenisë , 8001/07, Vendimi 27.10.2016 (Seksioni I)

Faktet - Kërkuesi i parë u ankua që ai ishte privuar në mënyrë arbitrare nga banesa dhe parcela e tij e tokës dhe atij i ishte mohuar gjykimi i drejtë në procesin gjyqësor pasues. Ai u ankua, ndër të tjera, që një prej gjyqtarëve

të përfshirë në çështje nuk kishte qenë i paanshëm pasi ishte përpjekur ta detyronte atë të pranonte një zgjidhje me pajtim duke e kërcënuar atë me efektet negative të refuzimit të tij.

Ligji – Neni 6 par 1: Nuk është e pazakontë në rendet juridike të Shteteve Kontraktues që palët të pyeten nëse ato e kanë vullnetin të bëjnë një zgjidhje me pajtim dhe të informohen në lidhje me pasojat procedurale. Kjo u shërben interesave të ekonomisë procedurale dhe administrimit të mirë të drejtësisë. Megjithatë, duke marrë parasysh rëndësinë e parimit të paanësisë gjyqësore, gjyqtarët që hetojnë vullnetin e palës për zgjidhje me pajtim duhet të bëjnë kujdes dhe të shmangin përdorimin e gjuhës që, e vlerësuar objektivisht, mund të justifikonte frikën që lind normalisht që gjyqtari në fjalë nuk është i paanshëm. Në çështjen në fjalë, gjyqtari e ftoi kërkuesin e parë të konsideronte propozimin e zgjidhjes me pajtim të prezantuar atij. Megjithatë, gjuha e përdorur nga gjyqtari gjatë seancës (ai deklaroi që gjykata i kushton gjithmonë rëndësi faktit që një palë ka refuzuar të nënshkruajë një zgjidhje të arsyeshme me pajtim dhe kjo ishte mundësia e fundit e kërkuesit për të diskutuar zgjidhjen) ishte qartazi e përshtatshme për të ngritur rezervën e ligjshme që refuzimi i kërkuesit të parë për të pranuar një zgjidhje me pajtim mund të kishte një ndikim negativ mbi shqyrtimin e themelit të çështjes së tij. Sipas mendimit të Gjykatës, sjellja e gjyqtarit nuk e kishte distancën e nevojshme që kërkohet nga parimi i neutralitetit gjyqësor dhe ngriti rezervën objektivisht të justifikuar që atij i mungonte paanësia.

Përfundim: shkelje (njëzëri)

Gjykata gjithashtu u shpreh njëzëri që ka patur shkelje të Nenit 6, par 1, të Konventës në lidhje me parimet e sigurisë ligjore dhe barazisë së armëve dhe shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

Neni 41: nën rezervë.

Neni 6, par 3(d)

Marrja në pyetje e dëshmitarëve Pranimi dhe përdorimi i përfundimeve penalizuese të një eksperti në mungesë: *nuk ka shkelje*

Constantinides kundër Greqisë, 76438/12, Vendimi 6.10.2016 (Seksioni I)

Faktet - Në kuadrin e një hetimi penal të kërkuesit në lidhje me falsifikim dhe përdorimin e dokumenteve të falsifikuara, u urdhërua një ekspertizë grafologjike. Raporti mbështeti qëndrimin e prokurorisë. Kërkuesi në vijim caktoi një ekspert të vetin, i cili paraqiti disa ekspertiza që kritikonin ekspertizat penalizuese. Në seancën gjyqësore ekspertiza penalizuese u diskutua nga eksperti i kërkuesit, i cili mbrojti gjetjet e veta. Megjithëse autori i ekspertizës penalizuese ishte thirrur për tu paraqitur, ajo nuk e ndoqi seancën dhe për këtë nuk u dha asnjë shpjegim. Kërkuesi u dënua. Në apel kërkuesi u ankua që atij nuk i ishte dhënë asnjë mundësi për ti bërë pyetje autorit të ekspertizës penalizuese, në shkelje të të drejtave të tij të mbrojtjes. Megjithatë, Gjykata e Apelit e konsideroi të panevojshme të ftonte ekspertin në fjalë për tu paraqitur, duke përfaqësuar mendimin që faji i kërkuesit ishte vërtetuar plotësisht nga një sërë provash bindëse.

Ligji – Neni 6 par 1 dhe 3 (d): Në vendimin e saj Schatschaschwili kundër Gjermanisë ((GC), 9154/10, 15 dhjetor 2015, Shënimi Informativ 191) në lidhje me mospraninë e dëshmitarëve të prokurorisë, Dhoma e Madhe konstatoi që: (a) mos-ekzistenca e një shkaku të fortë për mos-praninë e një dëshmitari nuk e bën gjykimin si të tillë të padrejtë, por megjithatë ishte një faktor i rëndësishëm në vlerësimin e drejtësisë në tërësi të një gjykimi dhe një faktor që mund ta anonte balancën në favor të gjetjes së një shkeljeje të Nenit 6, par 1 dhe 3 (d); (b) për qëllimet e këtij vlerësimi të përgjithshëm, ekzistenca e faktorëve të mjaftueshëm kundër-balancues duhej të rishikoheshin nga Gjykata jo vetëm në rastet në të cilat provat e dhëna nga një dëshmitar në mungesë kanë qenë baza e vetme ose vendimtare për fajësimin, por edhe në ato raste kur të paktën ka patur një peshë të konsiderueshme dhe pranimi i saj mund të ketë penguar mbrojtjen; (c) masa e faktorëve kundër-balancues të nevojshëm me qëllim që një gjykim të konsiderohet i drejtë varet nga rëndësia e provave të dëshmitarit në mungesë. Sa më e rëndësishme të jetë kjo provë, aq më shumë peshë

duhet të mbajnë faktorët kundër-balancues. Gjykata konsideroi që këto parime ishin të zbatueshëm *mutatis mutandis* për ekspertët në çështjen në fjalë. Ishte e vërtetë që në çështjen ne fjalë gjykatat greke nuk kishin bërë gjithçka që mund të pritej normalisht për të siguruar praninë e ekspertit i cili kishte shkruar ekspertizën penalizuese. Për më tepër, ishte e qartë nga teksti i vendimeve të shkallës së parë dhe apelit që ekspertiza në fjalë ishte konsideruar si një dokument i rëndësishëm. Megjithatë, kanë qenë të pranishëm shumë faktorë kundër-balancues. Së pari, kërkuesi ka patur një mundësi për të kundërshtuar përfundimet e ekspertizës penalizuese dhe e kishte përdorur këtë mundësi, veçanërisht duke paraqitur tre raporte të përgatitur nga eksperti i vet, i cili kishte paraqitur konstatimet e veta në sallën e gjyqit. Së dyti, kërkuesi nuk kishte shpjeguar asnjëherë - pas para Gjykatës - pse ai dëshironte të pyeste autorin e ekspertizës në seancën në apel. Ishte e vërtetë që mund të ketë qenë e papërshtatshme për të të deklaronte paraprakisht pyetjet që ai dëshironte ti bënte ekspertit. Megjithatë, do të ishte e arsyeshme për të që të paktën të bënte disi të ditur se pse ai i konsideronte këto pyetje si absolutisht të nevojshme ose çfarë do tu kishte shtuar kjo konstatimeve të ekspertit të vet. Së treti, gjykatat kishin theksuar që përmbajtja dhe konstatimet e ekspertizës në fjalë mbështesnin provat me dëshmitarë dhe një sërë dokumentesh të tjera zyrtare. Ekspertiza përbënte vetëm një prej artikujve të provave në dosjen e çështjes, e cila përmbante rreth njëqind dokumente që në total ishin rreth 1 500 faqe. Sipas mendimit të Gjykatës, kjo çështje duhej të dallohej nga: - çështjet në të cilat gjykata që ka fajësuar kërkuesin ka patur para saj një ekspertizë të marrë nga prokuroria pa pjesëmarrjen e mbrojtjes, dhe ku mbrojtja nuk ka qenë në gjendje të kundërshtonte konstatimet e ekspertizës në seance (shih Matytsina kundër Rusisë, 58428/10, 27 mars 2014, Shënimi Informativ 172);- çështjet në të cilat fajësimi i kërkuesit ishte bazuar në një masë vendimtare mbi provat e dëshmitarëve kundër tij, të cilat ai nuk kishte qenë në gjendje ti kundërshtonte në asnjë fazë (shi ndërmjet të tjerash Nikolitsas kundër Greqisë, 63117/09, 3 korrik 2014). Çështja në fjalë nuk ka të bëjë me dëshmitarë që kanë bërë deklarime në lidhje me ngjarjet që ata kishin përjetuar ose marrë dijeni nga të tjerët. Përkundrazi, kishte të bënte me një ekspertizë që ishte përgatitur nga një ekspert i pavarur i caktuar

nga autoritetet gjyqësore gjatë hetimit me qëllim dhënien gjykatës të një informacioni ose një aspekti teknik të çështjes, dhe konstatimet e të cilës ishin shqyrtuar me hollësi nga një ekspert i caktuar nga vetë kërkuesi. Në tërësi, ndërsa është e vërtetë që nuk është bërë gjithçka e mundur për ta detyruar personin në fjalë për tu paraqitur, mbetet fakt që ajo ishte thjesht eksperte dhe jo dëshmitare, që ekspertiza e saj nuk përbënte bazën e vetme ose vendimtare për fajësimin e kërkuesit ndërsa ekzistonin faktorë të mjaftueshëm kundër-balancues në rastin e kërkuesit që e bëjnë Gjykatën të konsiderojë që kërkesat e parimit të kontradiktoritetit ishin përmbushur. Për pasojë, të drejtat e kërkuesit për mbrojtje nuk ishin kufizuar në një masë që do të ishte në papajtueshmëri me kërkesat e një gjykimit të drejtë.

Përfundim: nuk ka shkelje (njëzëri)

Gjykata u shpreh gjithashtu që nuk ka patur shkelje të Nenit 6, par 1, në lidhje me arsyetimin e pretenduar të pamjaftueshëm të vendimit të Gjykatës së Kasacionit.

NENI 6

Gjykimi i drejtë

Mosvlerësimi imtësisht i provave në gjykimet civile nga gjykatat e brendshme: *shkelje*

Saliba kundër Maltës, 24221/13, Vendimi 29.11.2016 (Seksioni IV)

Faktet - Z. dhe Zj Z. e paditën kërkuesin në gjykimin civil për shkaktim dëmi që rezultonte nga një vjedhje me dhunë që kishte ndodhur në banesën e tre pesë vjet më parë. Në retrospektivë, megjithëse ai në atë moment nuk e kishte bërë një gjë të tillë, Z Z konsideroi që ai njohu kërkuesin si një prej vjedhësve. Kërkuesi u ankua që atij i ishte mohuar gjykimi i drejtë në pajtim me Nenin 6 të Konventës pasi gjykatat e brendshme nuk i kishin kushtuar vëmendjen e duhur vlefshmërisë, besueshmërisë dhe rëndësisë së provave të paraqitura para tyre.

Ligji – Neni 6, par 1: Neni 6, par 1, i cakton gjykatës si detyrë të kryejë një shqyrtim të rregullt të parashtesave, argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët. Shtetet Kontraktuese kishin një hapësirë më të madhe diskrecioni në trajtimin e çështjeve në lidhje me të drejtat dhe detyrimet civile nga sa kishin në trajtimin e çështjeve penale. Megjithatë, gjatë shqyrtimit të çështjeve që përfshiheshin në aspektin e së drejtës civile të Nenit 6, ishte e nevojshme të merrej si shembull qëndrimi përkundrejt çështjeve të së drejtës penale. Nuk ka dyshim që në çështjet që ngarkojnë me përgjegjësi penale për dëmin që rrjedh nga veprat penale, ishte e domosdoshme që vendimet e brendshme të bazoheshin në një vlerësim të hollësishëm të provave të paraqitura dhe që vendimet të përmbanin arsyetimin e mjaftueshëm për shkak të pasojave të ashpra që mund të rrjedhin nga këto konstatime. Përfundimet e gjykatës së shkallës së parë u bazuan në dëshmitë kontradiktore të Z. Z. Deklarimet e dëshmitarëve që vinin në dyshim vërtetësinë e dëshmisë së tij nuk ishin marrë parasysh. Në një kontekst penal, mospërputhjet ndërmjet deklarimeve të një dëshmitari të bëra në faza të ndryshme, si dhe mospërputhjet serioze ndërmjet tipeve të ndryshme të provave, normalisht do të përbënte shkak serioz për kundërshtimin e besueshmërisë së dëshmitarit dhe vlerës provuese të dëshmisë së tij ose të saj. Binte në sy që, ndërsa gjykata e brendshme theksoi papërputhshmëritë e Z. Z, ajo nuk dha asnjë shkak se pse ajo mendonte që deklarimet e tij mbetën të besueshme dhe të mirëqena. Një konsideratë e tillë ishte akoma më e rëndësishme duke ditur që identifikimi nga Z.Z i kërkuesit kishte ndodhur vetëm pesë vjet nga vjedhja me dhunë.

Përfundim: shkelje (njëzëri)

Neni 41: forma më e përshtatshme e kompensimit do të ishte rihapja e gjykimit nëse kjo do të kërkohej nga kërkuesi; 10 000 EURO në lidhje me dëmin jo-financiar; rrëzohet pretendimi në lidhje me dëmin financiar.

NENI 10

Liria e shprehjes

Dënimi i gazetarëve për publikimin satirik i konsideruar ofendues për prokurorin publik: *shkelje*

Grebneva dhe Alisimchik kundër Rusisë, 8918/05, Vendimi 22.11.2016 (Seksioni III)

Faktet - Kërkuesit ishin redaktori dhe gazetari i një gazete rajonale. Ata u dënuan në lidhje me një publikim që gjykatat e brendshme e konsideruan të ishte ofenduese për prokurorin rajonal. Ata u ankuan në pajtim me Nenin 10 të Konventës që dënimi i tyre kishte shkelur të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes.

Ligji – Neni 10: Dënimi i kërkuesve përbënte shkak për ndërhyrje në të drejtën e tyre të lirisë së shprehjes. Kjo ndërhyrje ndiqte qëllimin legjitim të mbrojtjes së emrit ose të drejtave të të tjerëve dhe ishte e parashikuar me ligj. Pyetja para Gjykatës ishte nëse dënimi i tyre kishte qenë i nevojshëm në një shoqëri demokratike. Gjykata theksoi rolin thelbësor të shtypit në një shoqëri demokratike dhe detyrën e tij për dhënien e informacionit dhe ideve mbi çështjet me interes publik. Kjo ishte veçanërisht e rëndësishme në periudhën para një zgjedhjeje që opinionet dhe informacioni i të gjitha llojeve të lejoheshin të qarkullonin lirisht. Kërkuesit kishin publikuar një numër çështjesh mbi fushatën e zgjedhjeve parlamentare që kishte filluar në rajonin e tyre në atë periudhë. Artikujt adresonin, në një mënyrë satirike dhe ngacmuese, shumë parregullsi që, sipas mendimit të kërkuesve, kishin ndodhur gjatë fushatës. E parë në tërësi, artikulli nuk mund të kuptohej si sulm personal dhe pa shkak ose si një ofendim për prokurorin. Krahasimet provokative nuk kishin të bënin me jetën e tij private ose familjare, por lidheshin qartazi me përgjegjësinë e tij institucionale si kreu i zyrës së prokurorisë për të gjithë rajonin. Materiali i publikuar denonconte korrupsionin e pretenduar gjatë fushatës zgjedhore. Kërkuesit kishin ngritur një çështje të rëndësishme me interes të përgjithshëm, që ata e konsideronin të rëndësishëm për shoqërinë dhe në këtë mënyrë hapjen e debatit publik. Arsyetimi skematik dhe i pashtjelluar i gjykatave të brendshme e bërë çdo

parashtrim të bërë nga kërkuesit pa asnjë efekt praktik. Gjykatat nuk kishin marrë parasysh fare kontekstin social dhe politik në të cilin ishte publikuar artikulli dhe nuk kishin shqyrtuar nëse ai përfshinte ndonjë çështje me interes të përgjithshëm. Veçanërisht, ato nuk kishin bërë asnjë përpjekje për të analizuar përmbajtjen e materialit të publikuar në kontekstin e fushatës së filluar ose natyrën satirike të publikimit dhe ironinë në bazë të tij. Së fundmi, ato nuk kishin gjetur një balancë ndërmjet të drejtës së prokurorit për ruajtjen e emrit të tij dhe lirisë së shprehjes së kërkuesve dhe detyrës së tyre, si gazetarë, të jepnin informacion me interes të përgjithshëm. Si të tilla, gjykatat e brendshme nuk kishin dhënë arsye me vend dhe të mjaftueshme për të justifikuar ndërhyrjen për të cilën ishte bërë ankesa. Pavarësisht ashpërsisë së dënimit që do të vendosej, ushtrimi i ndjekjes penale ndaj gazetarëve për ofendimet e pretenduara që kritikonin një figurë publike në një mënyrë që mund të konsiderohej si ofendim personal mund ti pengonte gazetarët nga kontribuimi në diskutimet publike të çështjeve që prekin jetën e komunitetit të tyre. Reagimi i autoriteteve të brendshme për artikullin satirik të kërkuesve nuk ishte proporcional me qëllimin legjitim të ndjekur dhe në këtë mënyrë nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Përfundim: shkelje (njëzëri)

Neni 41: 3 000 EURO në lidhje me dëmin jo-financiar; 920 Euro në lidhje me dëmin financiar.

Liria për marrjen e informacionit

Refuzimi nga ana e autoriteteve për dhënien e emrave të mbrojtësve publikë dhe numrin e emërimeve të tyre një OJQ-je që kryente një sondazh

Magyar Helsinki Bizottság kundër Hungarisë, 18030/11, Vendimi 8.11.2016 (GC)

Faktet - OJQ-ja kërkuese ishte themeluar në vitin 1989 me detyrën e monitorimit të zbatimit të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në Hungari dhe ofrimin e përfaqësimit, edukimit dhe trajnimit

përkatës ligjor. Në kuadrin e një sondazhi në lidhje me eficencën e sistemit të mbrojtjes publike, kërkuesi kërkoi nga departamente të ndryshëm të policisë emrat e mbrojtësve publikë që mbaheshin prej tyre dhe numrin e emërimeve përkatës të tyre. Shtatëmbëdhjetë departamente policie e përmbushën këtë kërkesë; pesë të tjera e deklaruan informacionin e kërkuar pas një ankimi gjyqësor të suksesshëm. Megjithatë, kërkuesi nuk pati sukses në ankimin e vet ndaj dy departamenteve të tjera të policisë që refuzuan të deklaronin informacionin e kërkuar. Kërkuesi u ankua sipas Nenit 10 që refuzimi i gjykatave të brendshme për të urdhëruar deklarimin e informacionit përbënte shkak për shkeljen e së drejtës së saj për akses në informacion.

Ligji - Neni 10 (a) Zbatueshmëria dhe ekzistenca e një ndërhyrjeje - Konventa duhej të interpretohej nën dritën e rregullave të parashikuara në Nenet 31 deri 33 të Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve të vitit 1969 dhe të objektit dhe qëllimit të Konventës e lexuar si një e tërë. Gjykata nuk mund të shpërfillë standardet e përbashkëta ndërkombëtare ose të së drejtës së brendshme dhe konsensusin që rrjedh nga instrumentet e specializuar ndërkombëtarë dhe praktika e Shteteve Kontraktuese mund bëhet gjithashtu objekt i shqyrtimit përkatës. Së fundmi, gjatë interpretimit të Konventës mund të investohen edhe mjetet suplementare të interpretimit duke përfshirë edhe dokumentet paraprake. Nën dritën e këtyre parimeve, Gjykata duhej të konsideronte nëse dhe deri në cilën masë një e drejtë aksesi tek informacioni në zotërim të shtetit mund të shihej si e përfshirë në objektin e Nenit 10, pavarësisht faktit që një e drejtë e tillë nuk del drejtpërdrejt nga teksti i asaj dispozite. Legjislacioni i brendshëm në pjesën më të madhe të Shteteve Kontraktuese e njihte të drejtën ligjore të aksesit të informacionit dhe ekzistonte një konsensus i gjerë në lidhje me nevojën për të njohur një të drejtë individuale aksesi në informacionin në zotërim të shtetit me qëllim që të mundësohet që publiku të shohë dhe të formojë një mendim për çdo çështje me interes publik, duke përfshirë mbi mënyrën e funksionimit të autoriteteve publike në një shoqëri demokratike. Një nivel i lartë konsensusi është arritur edhe në nivel ndërkombëtar. Veçanërisht, e drejta për të kërkuar informacion ishte garantuar shprehimisht në Nenin 19 të Konventës Ndërkombëtare mbi Liritë Civile dhe Politike të vitit 1966

dhe ekzistenca e së drejtës për të aksesuar informacion është konfirmuar nga Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut në një numër rastesh. Përveç kësaj Neni 42 i Kartës së Bashkimit Europian për të Drejtat e Njeriut u garanton qytetarëve të drejtën e aksesimit të dokumenteve të caktuar. Miratimi i Konventës së Këshillit të Europës për Akses në Dokumente Zyrtare, megjithëse kjo është ratifikuar nga vetëm shtate Shtete Anëtare, tregon një evoluim në vazhdim drejt njohjes së detyrimit të Shtetit për të garantuar akses në informacionin publik. Duke marrë parasysh këta faktorë, Gjykata nuk ishte e mendimit që ajo ishte e penguar në interpretimin e Nenit 10, par 1, pasi ai përfshin të drejtën e aksesit në informacion. Gjykata u shpreh që, në interes të sigurisë ligjore, parashikueshmërisë dhe barazisë para ligjit, ajo, pa patur një shkak të fortë, nuk do të shmangej nga precedentët e përcaktuar në çështjet e mëparshme por, meqenëse Konventa ishte para së gjithash një sistem për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duhet ti kushtohej vëmendje kushteve në ndryshim brenda shteteve Kontraktuese dhe Gjykata duhej të reagonte ndaj çdo përafrimi evolues në lidhje me standardet që duhet të arrihen. E drejta për të marrë informacion nuk mund të interpretohej sikur një Shteti i vendoseshin detyrime pozitive për të mbledhur dhe shpërndarë informacion me iniciativë të vet dhe që Neni 10 nuk i jep individit të drejtën e aksesit në informacionin në zotërim të një autoriteti publik apo të detyrojë Qeverinë për ti dhënë këtë informacion individit. Megjithatë, një e drejtë ose detyrim i tillë mund të lindë, së pari, nëse deklarimi i informacionit ishte detyruar nëpërmjet një urdhri gjyqësor që ka marrë formë të prerë dhe, së dyti, në rrethanat kur aksesi në informacion e ndihmon individin të ushtrojë të drejtat e tij ose të saj për lirinë e shprehjes, veçanërisht lirinë për të marrë dhe dhënë informacion dhe nëse refuzimi i tij përbënte një ndërhyrje tek ajo e drejtë. Nëse dhe në cilën masë refuzimi i aksesit në informacion përbënte ndërhyrje në lirinë e shprehjes së një kërkuesi duhej të vlerësohej rast pas rasti dhe në dritën e rrethanave të veçanta duke përfshirë: (i) qëllimin e kërkesës për informacion; (ii) natyrën e informacionit të kërkuar; (iii) rolin e kërkuesit; dhe (iv) nëse informacioni është i gatshëm dhe i disponueshëm. Gjykata ishte e bindur që kërkuesi në këtë rast dëshironte ta ushtronte të drejtën për të dhënë informacion mbi një çështje me interes publik dhe kishte kërkuar akses në informacion

për këtë qëllim dhe që informacioni ishte i nevojshëm për ushtrimin e së drejtës së tij të lirisë së shprehjes. Informacioni mbi emërimin e mbrojtësve publikë ishte e një natyrë të theksuar me interes publik. Nuk kishte arsye për të dyshuar që sondazhi në fjalë përmbante informacion që kërkuesi mori përsipër t'ia bënte të ditur publikut dhe që publiku kishte të drejtë ta merrte dhe Gjykata ishte e bindur që ishte e nevojshme për përmbushjen e kësaj detyrë që kërkuesi të kishte akses në informacionin e kërkuar. Së fundmi, informacioni ishte i gatshëm dhe i disponueshëm. Kështu që ka patur një ndërhyrje tek e drejta e mbrojtur nga Neni 10 që ishte e zbatueshme në këtë çështje. (b) Nëse ndërhyrja është e justifikuar - Gjykata pranoi që ndërhyrja ka qenë e parashikuar me ligj dhe që kufizimi i lirisë së shprehjes së kërkuesit ndiqte qëllimin legjitim të mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve. Kërkesa për të dhëna, megjithëse përbëhej nga të dhëna personale, kishte të bënte kryesisht me zhvillimin e aktiviteteve profesionale në kontekstin e procedimeve publike. Në këtë kuptim, aktivitetet profesionale të mbrojtësve publikë nuk mund të konsideroheshin të ishin një çështje private. Informacioni i kërkuar nuk kishte të bënte me veprimet e mbrojtësit publik ose vendimet në lidhje me kryerjen e detyrave të tyre si përfaqësues ligjorë ose konsultimet me klientët e tyre dhe Qeveria nuk kishte demonstruar që deklarimi informacionit të kërkuar mund të kishte ndikuar në gëzimin nga mbrojtësit publikë të të drejtës së tyre për respektimin e jetës private brenda kuptimit të Nenit 8 të Konventës. Nuk ishte shkak për të prezumuar që informacioni në lidhje me emrat e mbrojtësve publikë dhe emërimet e tyre nuk mund të bëhej i ditur për publikun nëpërmjet mjeteve të tjera. Interesat e përmendura nga Qeveria duke iu referuar Nenit 8 nuk ishin të një natyre dhe shkalle të tillë që mund të kërkonin aktivizimin e aplikimit të asaj dispozite dhe të fusnin në lojë një ushtrim balancimi kundrejt së drejtës së kërkuesit të mbrojtur nga Neni 10. Objekti i sondazhit kishte të bënte me eficiencën e sistemit të mbrojtësve publikë dhe ishte ngushtësisht e lidhur me të drejtën për një gjykim të drejtë, një e drejtë themelore në të drejtën hungareze dhe një e drejtë e një rëndësie themelore sipas Konventës. Çdo kritikë ose përmirësim i sugjeruar për një shërbim të lidhur drejtpërdrejt me të drejtat për një gjykim të drejtë duhej të shihej si subjekt i shqetësimeve legjitime publike. Gjykata ishte e bindur që kërkuesi synonte të kontribuonte

në debatin mbi çështjen e interesit publik dhe refuzimi për përmbushjen e kësaj kërkese efektivisht e kishte cenuar kontributin e tij në një debat publik për një çështje me interes të përgjithshëm. Megjithëse informacioni i kërkuar kishte të bënte me të dhëna personale, ai nuk përfshinte informacion jashtë sferës publike. Gjykata nxori përfundimin që, megjithë marzhin e vlerësimit të Shtetit, nuk ka patur një raport të arsyeshëm proporcionaliteti ndërmjet masës së kundërshtuar dhe qëllimit legjitim të ndjekur.

Përfundimi: shkelje (pesëmbëdhjetë vota me dy)

Neni 41: 215 EURO në lidhje me dëmin financiar; nuk është ngritur pretendim në lidhje me dëmin jo-financiar.

NENI 4 I PROTOKOLLIT Nr. 7

E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë

Procedimet paralele administrative dhe penale në lidhje me të njëjtën sjellje: *nuk ka shkelje*

A dhe B kundër Norvegjisë, 24130/11 dhe 29758/11, Vendimi 15.11.2016 (GC)

Faktet - Kërkuesve iu vendosën gjoba në procedimin administrativ për shkak të mosdeklarimit të disa të ardhurave në momentin e kompensimit tatimor Në procedimin paralel penal ata u fajësuan dhe u dënuan për mashtrim tatimor për të njëjtat mosveprime. Kërkuesit u ankuan në pajtim me Nenin 4 të Protokollit nr 7 që ata ishin ndjekur penalisht dhe dënuar dy herë për të njëjtën vepër penale. Më 7 korrik 2015, një Dhomë e Gjykatës vendosi të heqë dorë nga juridiksioni në favor të Dhomës së Madhe.

Ligji - Neni 4 i Protokollit Nr. 7: Kjo dispozitë përmbante tre garanci të qarta dhe parashikonte që për të njëjtën vepër penale askush nuk duhet (i) ti nënshtrohet gjykimit, (ii) gjykohet, ose (iii) dënohet. Nëse procedimi administrativ ishte me natyrë penale për qëllimet e Nenit 4 të Protokollit Nr 7, duhej të vlerësohej në bazë të tre kritereve Engel të zhvilluara për

qëllimet e Nenit 6 të Konventës. Çështja nëse veprat penale të trajtuara në gjykime të veçanta ishin të njëjtat kërkonin më shumë një vlerësim faktik se sa një vlerësim formal që konsiston në krahasimin e elementëve thelbësorë të veprave penale. Objekti i Nenit 4 të Protokollit Nr 7 ishte parandalimi i padrejtësisë për një person që ndiqet penalisht ose dënohet dy herë për të njëjtën sjellje të penalizuar. Ai nuk i ndalon sistemet ligjore që adoptojnë një qasje të integruar ndaj keqbërjes sociale në fjalë, dhe veçanërisht një qasje që përfshin faza paralele të reagimit ligjor nga autoritete të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme. Duhet të gjendet balanca e drejtë ndërmjet garantimit të duhur të interesave të individit të mbrojtur nga parimi *ne bis in idem*, nga njëra anë, dhe përmbushjes së interesit specifik të komunitetit për të qenë në gjendje të marrë një parashtrim rregullator të kalibruar të fushës përkatëse nga ana tjetër Neni 4 i Protokollit Nr 7 nuk e përjashton zhvillimin e procedimeve të dyfishta me kusht që të përmbushen disa kushte. Veçanërisht, Shteti i paditur duhej të demonstronte në mënyrë bindëse që procedimet e dyfishta në fjalë kanë qenë të lidhura në masë të mjaftueshme në lëndë dhe kohë. Kjo do të thotë që jo vetëm qëllimet e ndjekura dhe mjetet e përdorura për arritjen e tyre duhet të jenë në thelb plotësuese dhe të lidhura në kohë, por gjithashtu pasojat e mundshme të organizimit të trajtimit ligjor të sjelljes përkatëse në këtë mënyrë duhet të jenë proporcionale dhe të parashikueshme për personin e prekur. Faktorë të rëndësishëm për të përcaktuar nëse ka patur lidhje të ngushtë në masë të mjaftueshme në lëndë përfshijnë: (i) nëse këto procedime ndjekin qëllime plotësuese dhe në këtë mënyrë trajtojnë aspekte të ndryshme të keqbërjes shoqërore përkatëse, (ii) nëse dualiteti i procedimeve përkatëse është një pasojë e parashikueshme, si në ligj ashtu edhe në praktikë, (iii) nëse linjat përkatëse të procedimeve janë zhvilluar në mënyrë të tillë që të shmangin në masën e mundshme punën e dyfishtë në mbledhjen dhe në vlerësimin e provave, kryesisht nëpërmjet ndërveprimit të përshtatshëm ndërmjet autoriteteve të ndryshëm kompetentë për të siguruar që marrja e fakteve në një linjë të përdoret edhe në linjën tjetër dhe (iv) nëse sanksioni i vendosur në procedimin që ka marrë formë të prerë fillimisht merret parasysh në ato që kanë marrë formë të prerë më vonë, në mënyrë që të shmanget mbajtja e barrës së tepërt nga individi i prekur. Lidhja në kohë

duhet të jetë e afërt në masë të mjaftueshme për të mbrojtur individin ndaj pasigurisë dhe vonesës dhe ndaj shtyrjes së procedimit në kohë. Sa më e dobët të jetë lidhja në kohë aq më e madhe është barra mbi shtetin për të shpjeguar dhe justifikuar çdo vonesë të tillë që mund ti atribuohet zhvillimit të procedimit nga ana e tij. Autoritetet e brendshme kishin konstatuar që sjella e kërkuesve kërkonte dy reagime, një dënim administrativ dhe një penal. Dënimi administrativ i gjobës shërbente si frenues i përgjithshëm dhe si kompensim për punën e konsiderueshme dhe shpenzimet e pësuara nga autoritetet tatimore në emër të komunitetit për kryerjen e verifikimeve dhe auditimeve me qëllim që të identifikonin këto deklarata të mangëta. Dënimi penal shërbente jo vetëm si frenues, por kishte edhe një qëllim ndëshkimor në lidhje me të njëjtën keqbërje anti-sociale, duke përfshirë një element shtesë të kryerjes së mashtrimit me faj. Ishte veçanërisht e rëndësishme që, në dënimin e kërkuesve, gjykatat e brendshme të kishin parasysh faktin që ata i ishin nënshtruar një herë një sanksioni nëpërmjet vendosjes së një gjobe tatimore. Në këto rrethana, zhvillimi i procedimeve të dyfishta, me mundësinë e dënimeve të ndryshme shtuese ka qenë e parashikueshme dhe vërtetimit i fakteve të bëra në një linjë procedimi është mbështetur tek tjetri. Nuk kishte ndonjë tregues që kërkuesit të kishin pësuar ndonjë dëm ose padrejtësi dhe brenda të dy linjave të procedimeve kishte patur një lidhje të ngushtë në masë të mjaftueshme, në lëndë dhe në kohë.

Përfundimi: nuk ka shkelje (gjashtëmbëdhjetë vota me një)

NENI 1 I PROTOKOLLIT Nr. 1

Sendet në zotërim Pagesa e kompensimit të pjesshëm dhe jo e vlerës së plotë të shpronësimit për tokën e rënduar me kufizime faktike dhe ligjore për shkak të ndërtimit të një dige ujore në afërsi: *shkelje*

Kutlu dhe të tjerë kundër Turqisë, 51861/11, Vendimi 13.12.2016 (Seksioni II)

Faktet - Kërkuesit ishin pronarë të disa parcelave të tokës pranë së cilës ishte ndërtuar një digë ujore. Dy prej parcelave gjendeshin brenda zonës

së mbrojtjes maksimale rreth digës, ndërsa e treta ishte brenda zonës së brendshme të mbrojtjes. Kjo afërsi ishte shkak për një numër kufizimesh, si fizike (aksesi i vështirë, prishja e linjave telefonike dhe elektrike etj.,) dhe ligjore (ndalimi i punës ndërtimore dhe kufizimet mbi aktivitetet bujqësore). Duke synuar kompensimin për dëmin e pësuar, kërkuesit ngritën disa padi duke kërkuar që të shpronësoheshin nga toka. Gjykatat refuzuan të nxirrnin urdhra shpronësimi, por dhanë kompensim financiar.

Ligji - Neni 1 i Protokollit Nr. 1(a) Parcelat nr 84/72 dhe 84/76 - Përdorimi i parcelave është ndikuar nga kufizimet ekstreme fizike dhe ligjore: tek parcelat nuk mund të shkohet me mjete motorike; nuk lejohen ndërtime ndërsa punët bujqësore janë të ndaluara. Ligji vendoste shpronësimin nëse një parcelë toke në afërsi të digës 'nuk vazhdonte të ishte e përdorshme'. Rregullimet të cilave u referohej ligji specifikonin që parcelat që gjendeshin brenda zonës së mbrojtjes maksimale rreth një rezervuari të ujit të pijshëm 'shpronësohen'. Duke patur parasysh përdorimin e fjalës 'jam' dhe të foljes modale 'mund', ky tekst nuk u lejonte autoriteteve asnjë diskrecion vlerësimi dhe ato nuk e kanë mundësinë të zgjedhin ndërmjet shpronësimit dhe pagesës së një norme më të ulët të kompensimit. Përkundrazi, rregullimet ua hiqnin të gjithë diskrecionin autoriteteve duke i detyruar ato të përftonin tokën dhe në këtë mënyrë tu jepnin pronarëve të parcelave që gjendeshin brenda zonës së mbrojtjes maksimale një të drejtë legjitime të braktisjes, d.m.th., një të 'drejtë për tu shpronësuar'. Kjo e drejtë braktisjeje, e parashikuar në rregullimet e brendshme, ishte në thelbin e 'së drejtës pronësore' për qëllimet e Nenit 1 të Protokollit nr 1. E drejta për tu shpronësuar dhe për të marrë pagesën e kompensimit në përputhje me vlerën e parcelave të tokës përfshihej brenda 'posedimit'. Duke refuzuar shpronësimin e parcelave përkatëse të tokës dhe duke zgjedhur pagesën e kompensimit për dëmin që rrjedh nga kufizimet mbi përdorimin e sendeve në zotërim, autoritetet kishin shkelur të drejtën e tij të pronësisë, të njohur nga ligji i brendshëm dhe të mbrojtur nga Konventa. Një shkelje e tillë nuk mund të konsiderohej në pajtim me kërkesat e Nenit 1 të Protokollit nr 1, duke ditur që nuk kishte bazë ligjore, por që për këtë nuk ka ndonjë justifikim të vërtetë. Gjykatat kishin dhënë arsye të pamjaftueshme për vendimin e tyre për të urdhëruar pagesën e kompensimit që përputhet me uljen në

vlerë të tokës, dhe për të mos realizuar të drejtën e kërkuesit për ta braktisur duke nxjerrë një urdhër shpronësimi dhe dhënien e një kompensimi që të përputhet me vlerën e tokës. Në këtë aspekt, duhet të vihet në dukje që gjykatat e brendshme nuk kishin dalë me ndonjë qëndrim në lidhje me rregullimin e sipër-përmendur. As Qeveria nuk kishte dhënë ndonjë shkak të qenësishëm për këtë ndërhyrje. Përfundimi: shkelje (gjashtë vota me një) (b) Parcela nr 81/14 - Kjo parcelë e cila gjendej në zonën e brendshme të mbrojtjes u nënshtrohej një sërë kufizimesh që synonin të mbronin cilësinë e ujit brenda digës. Në këtë mënyrë, në të nuk lejohej asnjë ndërtim. Përveç kësaj, aktivitetet bujqësore autorizoheshin vetëm me pëlqimin e ministrisë përkatëse dhe duke iu nënshtruar kushtit që të mos përdorej asnjë lloj plehu apo produkti kimik. Rregullimet e brendshme nuk e parashikonin 'të drejtën për tu shpronësuar' në lidhje me këtë parcelë. Ligji e lidhte kërkesën për shpronësimin e tokës që ndodhej në afërsi të një dige me kushtin që të mos vazhdojë 'të jetë e përdorshme'. Megjithatë, gjykatat e brendshme nuk ishin shprehur që prona në fjalë ka qenë e papërdorshme brenda kuptimit të asaj dispozite. Kështu që nuk mund të thuhet që në këtë çështje kërkuesit kishin të drejtë të shpronësoheshin sipas këtij Neni. Në lidhje me rregullimet, ato nuk parashikonin që kufizimet (Shënimi Informativ 202 dhjetor 2016, Neni 1 i Protokollit nr 1, faqe 16) që preknin tokën që ndodhej në një zonë të brendshme të mbrojtur e bënte tokën automatikisht të papërdorshme dhe në këtë mënyrë nuk parashikonte ndonjë kërkesë për shpronësim. Për pasojë, në mungesë të një të drejte për tu shpronësuar të njohur nga ligji i brendshëm dhe që përfaqëson një të drejtë pronësore të mbrojtur nga Konventa dhe në këtë mënyrë 'posedimin', pagesa e kompensimit të barabartë me dëmin që rrjedh nga kufizimet rregullatore ishte e përshtatshme për të arritur një balancë të drejtë ndërmjet të drejtave të kërkuesve dhe atyre të shoqërisë. Eksperti i emëruar nga gjykata e kishte vlerësuar zhvlerësimin e tokës në vlerë si pasojë e kufizimeve në përdorimin e saj me 40%. Megjithatë gjykata e vendosi kompensimin në 25% të vlerës së sendit në zotërim duke iu referuar thjesht kritereve që duhej të merreshin parasysh. Ky nuk mund të konsiderohej si arsyetim i mjaftueshëm, duke ditur që gjykata nuk kishte vënë në dukje pse dhe si zbatimi i këtyre kritereve do të rezultonte në një masë zhvlerësimi të kufizuar në 25%. Mënyra në

të cilën ishte përcaktuar shuma e kompensimit nuk i mundësonte Gjykatës të nxirrte përfundimin që kjo ishte e lidhur në mënyrë të arsyeshme me dëmin e pësuar. Pa kërkuar një përgjigje të hollësishme për çdo argument të ngritur nga pretenduesi, detyrimi për gjykatat ti deklarojnë në mënyrë të përshtatshme këto arsye mbi të cilat kanë mbështetur vendimin e tyre nënkuptonte që pala e dëmtuar mund të priste që pretendimet e tij ose të saj kryesore të trajtoheshin me vëmendje dhe me kujdes. Për pasojë, nuk ka asnjë argument që do të mbështeste përfundimin që balanca e nevojshme dhe e drejtë ndërmjet interesit të përgjithshëm dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave të kërkuesve ishte gjetur.

Përfundim: shkelje (njëzëri)

Neni 41: 455.000 EURO në lidhje me dëmin financiar; së bashku për të gjithë kërkuesit ; 1 500 EURO secili në lidhje me dëmin jo-financiar.

Gëzimi paqësisht i sendeve në zotërim

Humbja e përfitimeve të paaftësisë për shkak të kritereve të përshtatshmërisë së prezantuara së rishtas: *shkelje*

Béláné Nagy kundër Hungarisë, 53080/13, Vendimi 13.12.2016 (GC)

Faktet - Në vitin 2001 kërkueses iu dha një pension paaftësie, i cili iu hoq në vitin 2010 pasi shkalla e paaftësisë së saj u ri-vlerësua i një niveli më të ulët duke përdorur një metodologji tjetër. Ajo iu nënshtrua vizitave të tjera në vitet në vazhdim dhe u vlerësua eventualisht në nivelin kualifikues. Megjithatë, legjislacioni i ri i cili kishte hyrë në fuqi në vitin 2012 prezantonte kritere shtesë përshtatshmërie, që kërkuesja nuk i përmbushte dhe që kishin të bënin me kohëzgjatjen e mbulimit të sigurimeve shoqërore. Për pasojë, megjithëse shkalla e paaftësisë së saj do ti kishte dhënë të drejtën asaj për një pagesë paaftësie në sistemin e ri, kërkesat e saj u refuzuan. Kërkuesja u ankua që ajo kishte humbur mjetet e saj të jetesës, që i ofroheshin vetëm nga pagesa e paaftësisë, si rezultat i ndryshimeve legjislative të zbatuara nga autoritetet në mënyrë të padrejtë, pavarësisht faktit që në shëndetin e saj

nuk kishte patur përmirësim. Në vendimin e saj të datës 10 shkurt 2015 (shih Shënimin Informativ nr 182) një Dhomë e Gjykatës u shpreh - katër vota me tre - që ka patur një shkelje të Nenit 1 të Protokollit nr 1. Veçanërisht, ajo u shpreh që kërkuesit nuk i ishte hequr tërësisht kujdesi për paaftësi për shkak të një ndryshimi drastik dhe të paparashikueshëm në kushtet e aksesit të tij të përfitimeve të paaftësisë. Më 1 qershor 2015, çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të Qeverisë. Ligji - Neni 1 i Protokollit 1 (a) Zbatueshmëria - Në rrethana të caktuara, një pritshmëri legjitime e përftimit të një përfitimi mund të gëzojë mbrojtjen e Nenit 1 të Protokollit nr 1. Një pritshmëri legjitime duhej të ishte e një natyre më konkrete se thjesht një shpresë dhe duhet të bazohet në një dispozitë ligjore ose një akt ligjor siç mund të jetë një vendim gjyqësor. Në të njëjtën kohë, një e drejtë pronësore e njohur sipas ligjit të brendshëm - edhe nëse është i revokueshëm në rrethana të caktuara - mund të përbëjë një posedim. Ndryshimet në legjislacionin e sigurimeve shoqërore mund të miratohen në përgjigje të ndryshimeve sociale dhe me ndryshimin e konceptimit mbi kategoritë e personave që janë në nevojë për ndihmë sociale. Nëse kushtet ligjore të brendshme për dhënien e një forme të caktuar përfitimi ose pensioni kanë ndryshuar dhe nëse personi përkatës nuk vazhdon ti përmbushë ato për shkak të një ndryshimi në këto kushte, mund të jetë e nevojshme shqyrtimi i kujdesshëm i rrethanave konkrete të çështjes - veçanërisht, natyrën e ndryshimeve në kërkesë - me qëllim që të verifikohet ekzistenca e një të drejtë pronësore lëndore të bazuar në masë të mjaftueshme sipas ligjit të brendshëm. (Shënimi Informativ 202 i muajit dhjetor 2016, Neni 1 i Protokollit nr 1, Faqe 17). Kërkuesja i përmbushte të gjitha kushtet e përshtatshmërisë për marrjen e pensionit të paaftësisë si një e drejtë për pothuaj dhjetë vjet. Vendimi që i jepte asaj pension paaftësie në pajtim me dispozitat e ligjit përkatës dhe që përbënte bazën e së drejtës së saj fillestare mund të konsiderohej sikur përfaqësonte një posedim ekzistues. Gjatë gjithë kësaj periudhe dhe në bazë të këtij ligji, ajo mund të ushqente një pritshmëri të caktuar legjitime për vazhdimin e përftimit të përfitimeve të paaftësisë nëse paaftësia e saj do të vazhdonte në shkallën e kërkuar. Pyetja është, nëse në momentin e hyrjes në fuqi të legjislacionit të ri në vitin 2012 kërkuesja vazhdonte të kishte një pritshmëri legjitime për marrjen e përftimit të paaftësisë. Ndryshimi në ligj efektivisht vendoste mbi

një kategori të caktuar të personave të siguruar, duke përfshirë kërkuesen, një kusht që nuk ka qenë i parashikueshëm gjatë periudhës përkatëse kontribuuese dhe që ata mund të mos e përmbushnin pas hyrjes në fuqi të legjislacionit të ri. Gjatë periudhës ndërhyrëse ndërmjet ndërprerjes së pensionit të kërkueses për paaftësi në vitin 2010 dhe prezantimit nga legjislativi të kërkesës së re për kontributet në vitin 2012, kërkuesja jo vetëm ishte pjesë ë sistemit të sigurimeve sociale, por vazhdonte të përmbushte kërkesat përkatëse të kohëzgjatjes së shërbimit për përfitimet e paaftësisë. Si e tillë, ndërsa nuk merrte pension, ajo vazhdonte të ushqente pritshmërinë legjitime të mbuluar nga koncepti i posedimit në Nenin 1 të Protokollit nr 1. E drejta e kërkueses për të përftuar përfitime nga skema e sigurimeve sociale në fjalë ishte shkelur në një mënyrë që përbënte shkelje të të drejtave të saj të pensionit. Në këtë mënyrë ishte i zbatueshëm Neni 1 i Protokollit 1. (b) Përputhshmëria me Nenin 1 të Protokollit nr 1 - Gjykata ishte e bindur që ndërhyrja ishte në pajtim me kërkesat e ligjshmërisë dhe ndiqte një interes të përgjithshëm në mbrojtje të financave publike, nëpërmjet racionalizimit të sistemit të përfitimeve nga sigurimet sociale me shkak paaftësinë. Neni 1 i Protokollit nr 1 kërkonte që çdo ndërhyrje të ishte proporcionale në masë të mjaftueshme me qëllimin që kërkohet të realizohet. Balanca e drejtë e kërkuar nuk mund të arrihen nëse personit përkatës i vihen një barrë individuale dhe e tepërt. Kërkueses i ishte hequr tërësisht e drejta, në vend që ti ishte bërë një ulje e pranueshme në përfitimet e saj. Ajo nuk kishte asnjë të ardhur tjetër të konsiderueshme mbi të cilën mund të mbështetej dhe ajo kishte vështirësi në ushtrimin e një punësimi me shpërblim dhe i përkiste një grupi të pambrojtur të personave me aftësi të kufizuar. Masa e kundërshtuar, megjithëse ajo synonte të mbronte financat publike duke riformatuar dhe racionalizuar skemën e përfitimeve të paaftësisë përbëhej nga një legjislacion i cili, në rrethanat përkatëse, nuk arrinte ndonjë balancë të drejtë ndërmjet interesave në fjalë. Këto konsiderata nuk mund të justifikojnë masat legjislative me efekt prapaveprues dhe pa masa transitore që të përputhen me situatën përkatëse, duke shkaktuar, si në këtë rast, pasojën e mohimit të pritshmërisë së ligjshme që ajo do të merrte përfitimet e saj të paaftësisë. Një ndërhyrje e tillë themelore tek të drejtat e kërkueses ishte në papajtueshmëri me ruajtjen e një balance të

drejtë ndërmjet interesave në fjalë. Nuk ka patur ndonjë lidhje të arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet qëllimit të ndjekur dhe mjeteve të zbatuara. Megjithë marzhin e gjerë të vlerësimit nga ana e shtetit, kërkueses iu desh të mbante një barrë te tepërt individuale.

Përfundimi: shkelje (nëntë vota me tetë) Neni 41: 5 000 EURO në lidhje me dëmin jo-financiar; 10 000 Euro në lidhje me dëmin financiar.

NENI 4 I PROTOKOLLIT Nr. 4

Ndalimi i dëbimit kolektiv të të huajve

Shpërngulja për në Tunizi i një grupi të madh emigrantësh tunizianë të ardhur nga deti pasi ishte identifikuar secili individualisht dhe ishin lejuar të ngrinin kundërshtimet personale: *nuk ka shkelje*

Khlaifia dhe të tjerë kundër Italisë, 16483/12, Vendimi 15.12.2016 (GC)

Faktet - Kërkuesit, të cilët ishin shtetas tunizianë, ishin pjesë e një grupi emigrantësh që u nisën me anije nga Tunizia në shtator të vitit 2011 në drejtim të Italisë. Anijet e tyre provizore u pikasën nga Roja Bregdetare Italiane, e cila i shoqëroi ata tek një port në ishullin e Lambeduzës, ku ata u sistemuan në një qendër të pritjes paraprake (SCPA). Qendra u shkatërrua nga zjarri gjatë një trazire dhe kërkuesit u futën nëpër anije që ishin ankoruar në molin e Palermos. Ata u pajisën me urdhra ndalimi hyrjeje. Para se të futeshin në aeroplanë me destinacion Tunizinë, ata u pritën nga Konsulli Tunizian i cili regjistroi identitetet e tyre. Me të mbërritur në Tunizi, ata u liruan. E gjitha seria e ngjarjeve vazhdoi për dymbëdhjetë ditë. Në vitin 2012, një gjyqtar i refuzoi ankimet e një numri shoqatash për abuzim me pushtetin dhe arrestin arbitrar. Në një vendim të datës 1 shtator 2015 (shih Shënimin Informativ 188), një Dhomë e Gjykatës konstatoi një shkelje të Nenit 4 të Protokollit nr. 4 të Konventës për shkak të mungesës së garancive të përshtatshme për një shqyrtim të thellë dhe të vërtetë të (Shënim Informativ 202, dhjetor 2016, Neni 4 i Protokollit Nr 4, Faqe 21) situatës individuale të çdo kërkuesi; një shkelje të Nenit 13 të Konventës për shkak

të mungesës së efektit pezullues të mjeteve përkatëse të ankimit; një shkelje të Nenit 5, par 1 (mungesa e bazës ligjore për heqjen e lirisë) dhe të Neneve 5, par 2, dhe Nenit 5, par 4; një shkelje të Nenit 3 për kushtet e ndalimit në qendër dhe nuk ka shkelje të Nenit 3 për ndalimin në anije; dhe një shkelje të Nenit 13 për mungesën e mjeteve të ankimit në këtë kontekst. Më 1 shkurt 2016, çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të Qeverisë. Ligji - Neni 4 i Protokollit Nr. 4: Neni 4 i Protokollit Nr. 4 nuk e garantonte të drejtën e një interviste individuale në të gjitha rrethanat; kërkesat e kësaj dispozite duhet të përmbushen dhe çdo i huaj duhet ë ketë mundësinë e vërtetë dhe efektive për paraqitjen e argumenteve kundër dëbimit të tij ose të saj, dhe ku këta argumente të shqyrtohen në një mënyrë të përshtatshme nga autoritetet e Shtetit të paditur. Në çështjen konkrete, kërkuesit, të cilët normalisht mund ta kishin pritur që do të ktheheshin në Tunizi, kishin mbetur për rreth ndërmjet nëntë dhe dymbëdhjetë ditëve në Itali. Edhe nëse prezumohet që ata kishin hasur vështirësi objektive në CSPA ose në anije, gjatë asaj periudhe kohore jo tepër të konsiderueshme, ata kanë patur mundësinë e tërheqjes së vëmendjes së autoriteteve të brendshme në lidhje me çdo rrethanë që mund të ndikonte në statusin e tyre dhe tu jepte të drejtë atyre të mbeteshin në Itali. Së pari, kërkuesit kishin kaluar në dy kontrolle identiteti: (a) Kontrolli i parë i identitetit, sipas Qeverisë së paditur, kishte ndodhur pas mbërritjes së kërkuesve në qendrën e pranimit dhe kishte përfshirë bërjen e fotografive dhe regjistrimin e shenjave të gishtave të tyre. Ndërsa qeveria nuk kishte dhënë të dhëna personale për kërkuesit, ata ia kishin veshur këtë mosveprim në mënyrë të besueshme zjarrit në qendër. Në lidhje me mungesën e pretenduar të komunikimit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë ndërmjet emigrantëve dhe autoriteteve italiane, ishte e arsyeshme që të prezumohej që vështirësitë ishin zbutur nga prania e padiskutueshme në qendër e rreth njëqind operatorëve socialë, duke përfshirë punonjës socialë, psikologë dhe rreth tetë interpretë dhe ndërmjetës kulturorë. (b) Një kontroll i dytë identiteti u zhvillua para se kërkuesit të hipnin në bordin e avionëve për në Tunizi: ata ishin pritur nga konsulli Tunizian, i cilik ishte regjistruar identitetet e tyre. Megjithëse kontrolli ishte bërë nga përfaqësuesit e një Shteti të tretë, kontrolli i tyre pasues mundësoi verifikimin e shtetësisë së emigrantëve dhe u dha atyre

një mundësi të fundit për të paraqitur argumente kundër dëbimit ose shkaqe si mosha ose shtetësia (disa prej emigrantëve në këtë mënyrë nuk ishin kthyer). Së dyti, urdhrat e moslejimit të hyrjes ishin përpiluar në terma të krahasueshëm, duke ndryshuar vetëm tek të dhënat personale të çdo emigranti; natyra relativisht e thjeshtë dhe e standardizuar e urdhrave mund të shpjegohej me faktin që kërkuesit nuk kishin ndonjë dokument të vlefshëm udhëtimi dhe nuk kishin pretenduar që kishin frikë nga keqtrajtimi në rast kthimi ose që ka patur ndonjë pengesë tjetër ligjore për dëbimin e tyre. Kështu që nuk ishte e paarsyeshme që ata urdhra të justifikoheshin thjesht nga shtetësia e kërkuesve, duke vënë në dukje që ata kishin kaluar kufirin italian në mënyrë të paligjshme, dhe nga mungesa e ndonjë situate të parashikuar nga ligji përkatës (azil politik, dhënia e statusit të refugjatit ose miratimi i masave të përkohshme të mbrojtjes për shkaqe humanitare). Së treti, nuk ka qenë vendimtare që një numër i madh emigrantësh tunizianë ishin dëbuar në momentin përkatës ose që tre kërkues ishin dëbuar virtualisht në të njëjtën kohë. Kjo mund të shpjegohet si rezultat i një sërë urdhrash individuale refuzimi hyrjeje. Këto konsiderata ishin të mjaftueshme për tu dalluar nga çështjet Čonka kundër Belgjikës (51564/99, 5 shkurt 2002, Shënim Informativ 39), Hirsi Jamaa dhe të Tjerë kundër Italisë (27765/09, 23 Shkurt 2012, Shënim Informativ 149), Gjeorgjia kundër Rusisë (I) (GC) (13255/07, 3 korrik 2014, Shënim Informativ 176) dhe Sharifi dhe të Tjerë kundër Italisë dhe Greqisë (16643/09, 21 tetor 2014, Shënim Informativ 178). Përveç kësaj, përfaqësuesit e kërkuesve nuk kishin qenë në gjendje të vinin në dukje shkakun më të vogël faktik ose ligjor që, sipas ligjit të brendshëm ose ndërkombëtar, do të kishte justifikuar praninë e klientëve të tyre në territorin italian dhe përjashtuar largimin e tyre. Kjo vinte në pikëpyetje dobinë e një interviste individuale në çështjen në fjalë. Si përfundim, kërkuesit kishin kaluar nëpër dy kontrolle identiteti, shtetësia e tyre ishte verifikuar dhe atyre u ishte dhënë një mundësi e vërtetë dhe efektive për të paraqitur argumentet e tyre kundër dëbimit. Përfundimi: nuk ka shkelje (gjashtëmbëdhjetë vota me një) (Shënimi Informativ 202 dhjetor 2016, Neni 4 i Protokollit nr 4, faqe 22,) Neni 13 i Konventës i marrë së bashku me Nenin 4 të Protokollit 4: Në çështjen konkrete, urdhrat e refuzimit të hyrjes tregonin shprehimisht që individët e interesuar mund të depozitonin

ankim para gjyqtarit të Paqes në Agrigento brenda një periudhe prej gjashtëdhjetë ditësh. Nuk kishte arsye për të dyshuar që, në këtë kontekst, Gjyqtari i Paqes do të kishte tagrin të shqyrtonte çdo ankesë në lidhje me mosmarrjen parasysh të situatës personale të emigrantit të interesuar dhe po ashtu, në pikëpamje lëndore, bazuar në natyrën kolektive të dëbimit. Në lidhje me faktin që ky ankim nuk pati efekt pezullues, një analizë e thellë e De Souza Ribeiro kundër Francës, Vendimi ((GC), 22689/07, 13 dhjetor 2012, Shënim Informativ 158), krahasuar me vendimet Čonka dhe Hirsi Jamaa dhe të Tjerë, cituar më sipër, bëri që Gjykata të arrinte përfundimet e mëposhtme. Nëse një kërkues nuk kishte pretenduar që ai do të përballej me shkeljet e Nenit 2 ose 3 të Konventës në vendin e destinacionit, largimi nga territori i shtetit të paditur nuk do ta ekspozonte atë ndaj një dëmi të një natyre të pakthyeshme. Në këto raste Konventa në këtë mënyrë nuk vendoste ndonjë detyrim absolut për një shtet për të garantuar një mjet mbrojtës automatikisht pezullues, por vetëm kërkonte që personi i interesuar të ketë një mundësi efektive të kundërshtimit të vendimit të dëbimit duke mundësuar një shqyrtim të hollësishëm të ankimeve të tij ose të saj të kryera nga një forum i pavarur dhe i paanshëm e i brendshëm. Në rastin në fjalë, mjeti mbrojtës i disponueshëm i përmbushte këto kërkesa. Për më tepër, fakti që mjeti mbrojtës i disponueshëm për kërkuesin nuk kishte efekt pezullues nuk ka qenë një konsideratë vendimtare për përfundimin e arritur në çështjen De Souza Ribeiro. Përfundimi ishte bazuar në faktin që ankimi i 'argumentueshëm' i kërkuesit sipas Nenit 8 të Konventës ishte rrëzuar në mënyrë tepër të nxituar (largimi i tij për një Brazil ishte zbatuar në më pak se një orë pas ankimit të tij në Gjykatën Administrative). Përfundimi: shkelje (gjashtëmbëdhjetë vota me një) Neni 3: Kërkuesit ishin ankuar në lidhje me kushtet në të cilat ata ishin mbajtur. Pas ri-përsëritjes se faktorët në lidhje me rritjen e mbërritjeve të emigrantëve nuk i lironin Shtetet Anëtare nga detyrimet e tyre, Gjykata doli me mendimin që do të ishte artificiale të shqyrtoheshin faktorët e çështjes jashtë kontekstit të emergjencës humanitare. Viti 2011 kishte shënuar një krizë të madhe emigrimi. Mbërritja masive e emigrantëve nga Afrika Veriore (mbi 50 000 gjatë vitit) në Lampeduzë dhe Linosë pa dyshim që kishte krijuar vështirësi organizative, logjistike dhe strukturore për autoritetet Italiane. Përveç situatës së

përgjithshme, ka patur edhe probleme specifike pas mbërritjes së emigrantëve që kontribuuan në acarimin e vështirësive ekzistuese dhe duke krijuar një klimë të tensionit të shtuar: një revoltë ndërmjet emigrantëve në qendrën e pritjes; një sulm me zjarr i cili e prishi qendrën; një demonstratë nga 1 800 emigrantë në rrugët e Lampeduzës; përplasjet ndërmjet komunitetit vendas dhe një grupi të huajsh që kërcënonin të shpërtheni bombola gazi; dhe sulmet vetë-dëmtuese dhe vandalizmat. Këto hollësi tregonin që shteti ishte përballur me shumë probleme si rezultat i mbërritjes së një numri tepër të lartë të emigrantëve dhe që autoritetet ishin ngarkuar me një larmi të madhe detyrash, pasi ato duhej të garantonin mirëqenien e emigrantëve dhe të popullatës lokale për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë. Vendimi për të përqendruar pritjen fillestare të emigrantëve në Lampeduzë nuk mund të kritikohej si i tillë. Si rezultat i vendndodhjes së saj gjeografike, nuk ishte e paarsyeshme të transferoheshin të mbijetuarit në qendrën më të afërt të pritjes. (a) Kushtet në qendrën e pritjes - Gjykata konstatoi, duke vënë në dukje pikat e mëposhtme, që kushtet në të cilat ishin mbajtur kërkuesit në qendrën nuk e arrinin pragun e ashpërsisë që kërkohej që ato të karakterizoheshin si çnjerëzore dhe poshtëruese. (i) Ndërsa raporte të caktuara të komisioneve parlamentare ose OJQ-ve tregonin se ka patur mbipopullim në qendër, së bashku me mungesën e higjienës, hapësirave private dhe kontaktit me jashtë, konstatimet e tyre balancoheshin nga një raport i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës që mbulonte një periudhë që ishte më e afërt me qëndrimin e kërkuesve atje, kështu që kushtet në fjalë nuk mund të krahasoheshin me ato që kishin bërë Gjykatën të konstatonte një shkelje të Nenit 3 në çështje të tjera. (ii) Megjithëse numri për metra katrorë për person në mjediset e qendrës nuk ishin konstatuar, dhe duke supozuar që kapaciteti maksimal i qendrës (Shënimi Informativ 202 dhjetor 2016 Juridiksionet e tjera Faqe 23) ishte tejkaluar me një përqindje prej rreth 15% dhe 75%, liria e lëvizjes që gëzohej nga kërkuesit në qendër duhej të kishte zbutur këto kufizime. (iii) Megjithëse kërkuesit ishin dobësuar pasi sapo kishin kaluar detin, ata nuk kishin ndonjë dobësi specifike (ata nuk ishin azil-kërkues, nuk pretendonin të kishin kaluar eksperienca traumatike në vendin e tyre të origjinës, nuk u përkisnin kategorive të personave të moshuar ose të të miturve, dhe nuk pretendonin

të vuanin nga ndonjë gjendje e veçantë mjekësore). (iv) Atyre nuk u mungonte ushqimi ose uji apo kujdesi mjekësor dhe nuk ishin ekspozuar ndaj kushteve të vështira të motit. (v) Duke patur kohëzgjatjen e shkurtër të qëndrimit të tyre (3-4 ditë), mungesa e kontaktit të tyre me botën e jashtme nuk ka patur ndonjë pasojë të rëndë individuale. (vi) Ndërsa autoritetet kishin detyrimin të ndërmerrnin hapat për të gjetur mjedise të tjera të pranueshme pritjeje me hapësirë të mjaftueshme për të transferuar një numër të mjaftueshëm emigrantësh në këto mjedise, në këtë çështje Gjykata nuk mund të trajtonte çështjen nëse ky detyrim ishte përmbushur, pasi vetëm dy ditë pas mbërritjes së dy kërkuesve të fundit, Lamedusa CSPA ishte prishur nga zjarri gjatë një revolte. (vii) Në përgjithësi, situatat që Gjykata i kishte konsideruar ndonjëherë në shkelje të Nenit 3 kishin qenë më intensive dhe me një kohëzgjatje më të gjatë. Përfundim: nuk ka shkelje (njëzëri) (b) Kushtet në bordin e dy anijeve - Pragu i ashpërsisë nuk ishte arritur as në anije. Së pari, kërkuesit nuk paraqitën ndonjë dokument ose prova nga pala e tretë që të vërtetojë ndonjë shenjë të keqtrajtimit të pretenduar ose të konfirmonin versionin e fakteve (mbipopullimin, ofendimet, mungesën e higjienës), kështu që nuk ka shkak për të përmbysur barrën e provës. Së dyti, mund të shihej, nëpërmjet kontrastit, nga një vendim gjyqësor (bazuar në një njoftim të një agjencie shtypi dhe duke mos patur arsye për të dyshuar që ishte marrë duke respektuar garancitë procedurale përkatëse) që një Deputet kishte shkuar në bordin e anijeve dhe kishte vërejtur që emigrantët ishin akomoduar në kushte të pranueshme. Përfundim: nuk ka shkelje (njëzëri) Gjykata konstatoi gjithashtu unanimisht që nuk ka patur shkelje të Nenit 5, par 1 (dhe për pasojë të Neneve 5, par 2, dhe 5, par 4) për shkak ë mungesës së bazës ligjore për heqjen e lirisë së kërkuesve. Ndalimi i tyre de facto pa asnjë vendim formal u kishte mohuar atyre garancitë kushtetuese *habeas corpus* që u njihen individëve që mbahen në një qendër kthimi dhe, edhe në kontekstin e një krize emigracioni, kjo nuk mund të ishte në pajtueshmëri me Nenin 5 ë Konventës. Ka patur gjithashtu shkelje të Nenit 13 të marrë së bashku me Nenin 3 në lidhje me kushtet e ndalimit. Neni 41: 2 500 EUR për secilin prej kërkueseve për dëmin jo-financiar.

II. AKTGJYKIMET KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

***Kitanovska Stanojkoviq dhe të tjerë kundër Republikës së Maqedonisë, A. nr. 2319/14*,** aktgjykimi i datës 13 tetor të vitit 2016.

Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut (GJEDNJ) më datën 13.10.2016 solli aktgjykimin në lidhje me rastin Kitanovska Stanojkoviq dhe të tjerë kundër Republikës së Maqedonisë. Ankuesit janë ankuar, se Qeveria e thirrur në përgjegjësin nuk i ka realizuar obligimet e saja të cilat pasojnë nga neni 2 dhe neni 8 i Konventës.

Përkatësisht, ankesa ka qenë e parashtruar më datën 31 dhjetor të vitit 2013 nga ana e tre nënshtetasve të Maqedonisë, zonja Ollga Kitanovska Stanojkoviq ("ankuesi i parë"), zonja Svetllana Audiger (Audigier) (mbiemri i vajzërisë Kitanovska) (ankuesi i dytë") dhe zonja Olivera Menart (Menart) (mbiemri i vajzërisë Kitanovska) ("ankuesi i tretë").

Faktet në lidhje me rastin

- **Procedura penale në lidhje me hajdutërinë**

  Më 25 tetor të vitit 2011, dy persona (F.T. dhe S.G.) me maska të zeza në kokë kanë hyrë në shtëpinë e ankuesve, me qëllim që të kryejnë plaçkitje. Të njëjtit, personit V.K. (bashkëshorti dhe babai i ankuesve) dhe ankuesit të parë i kanë shkaktuar lëndime të rënda trupore. Si pasojë e kësaj, më 1 nëntor të vitit 2011, personi V.K. ka ndërruar jetën. Pas incidentit, ankuesi i parë ka qenë i pranuar në spital ku ka qëndruar në përkujdesjen intensive mjekësore deri më 4 nëntor të vitit 20011.

  Më 3 nëntor të vitit 2011, Gjykata themelore Shkup I – Shkup, ka përcaktuar masën e paraburgimit prej pesëmbëdhjetë ditëve për personin me iniciale

F.T. Paraburgimi ka qenë i përcaktuar për shkak të mundësisë dhe rrezikut për arratisjen e tij si dhe për shkak të rrezikut të ndikimit mbi hetimin, përkatësisht për shkak të rrezikut që ai të ndikoj mbi dëshmitarët për shkakun se të njëjtit jetojnë në afërsi të vendbanimit të tij.

Më 17 nëntor të vitit 2011, paraburgimi ka qenë i vazhduar edhe për 15 ditë shtesë.

Më 1 dhjetor të vitit 2011, gjykatësi hetues duke i pasur parasysh rrethanat personale dhe nevojat e F.T. përkatësisht moshën e tij, për shkak të faktit se ai është nxënës i rregullt në vitin e tretë të arsimit të mesëm dhe se është një person i moshës së re në fazë të zhvillimit, ai ka urdhëruar lirimin e tij, në të njëjtën kohë duke e pasur parasysh faktin se prezenca e tij në proceset gjyqësore ka qenë e mundur që të sigurohet përmes një mase më të lehtë, përkatësisht me marrjen e pasaportës dhe me përcaktimin e obligimit që të paraqitet në gjykatën.

Më 7 qershor të vitit 2012 Gjykata themelore Shkup I – Shkup, S.G. dhe F.T. i ka shpallur fajtor për hajdutëri dhe në bazë të nenit 237 (4) në lidhje me paragrafin 1 të Kodit penal, i ka gjykuar me dënimin me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë dhe pesë viteve, në mënyrë përkatëse.

Me aktgjykimet e 26 nëntorit të vitit 2012 dhe të 12 marsit të vitit 2013, Gjykata e apelit në Shkup si dhe Gjykata Supreme, në mënyrë përkatëse i kanë refuzuar mjetet juridike të parashtruara nga ana e F.T. me arsyetimet e ekzistimit të gjendjes së gabuar faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, si dhe për shkak të shkeljeve të procedurës. Dy gjykatat e kanë konfirmuar aktgjykimin e gjykatës së instancës më të ulët, duke mos gjetur shkaqe që të refuzojnë gjendjen faktike të konstatuar nga gjykata gjykuese dhe të shkaqeve që kjo gjykatë i ka përcaktuar në lidhje me personat e gjykuar.

- **Përmbarimi i dënimit të shqiptuar me burgim**

Më 2 janar të vitit 2013, gjykatësi për përmbarim të sanksioneve ka përcaktuar aktin udhëzues për F.T. sipas të cilit ai ka qenë i detyruar që të paraqitet në burgun e Ohrit më 30 janar të vitit 2013 për vuajtjen e dënimit me burgim. Më 17 janar të vitit 2013, F.T. ka kërkuar prolongimin e

përmbarimit të dënimit me burgim, për shkaqe familjare dhe shëndetësore. Kjo kërkesë atij i është refuzuar me vendimet e datës 21 janar dhe 12 shkurt të vitit 2013 nga ana e gjykatësit për përmbarim të sanksioneve dhje nga ana e këshillit gjyqësorë prej tre anëtarëve të gjykatës gjykuese, në mënyrë përkatëse. Më 21 shkurt të vitit 2013, burgu e ka njoftuar gjykatësin për përmbarim të sanksioneve se F.T. nuk është paraqitur në burgun në ditën e përcaktuar. Me shkresën e 28 shkurtit, 8 prillit dhe të 20 majit të vitit 2013, gjykatësi për përmbarim të sanksioneve e ka njoftuar gjykatën gjykuese në Shkup, me kompetenca për personat e moshës së mitur, se F.T. nuk është paraqitur në ditën e përcaktuar në burgun dhe ka kërkuar udhëzime "duke pasur parasysh natyrën urgjente të procedurës". Këto letra kanë mbetur pa përgjigje.

Më 30 qershor të vitit 2014, gjykatësi për përmbarim të sanksioneve, ka urdhëruar që F.T. të arrestohet. F.T. ka qenë i privuar nga liria më 10 korrik të vitit 2014 dhe ka filluar me vuajtjen e dënimit me burg më 11 korrik të vitit 2014. Burgu me letër ka konfirmuar se F.T. do të mbetet në burg deri më 27 qershor të vitit 2019.

- Parashtresat e dorëzuara nga palët

Ankuesit, të cilët tani jetojnë në Francë, kanë theksuar se një periudhë më të gjatë kohore nuk ka qenë i përcaktuar gjykatësi për përmbarim të sanksioneve dhe për këtë arsye aktgjykimi nuk ka qenë i përmbaruar. Gjithashtu, ata pohojnë se në këtë rast kemi shkeljen e nenit 2 që ka të bëjë me kërcënimin e vazhdueshëm që për të njëjtit ka paraqitur F.T. dhe ndjenja e mos dënimit, ndjenjë kjo të cilin ai e ka gëzuar gjatë pritjes që organet kompetente të zbatojnë masën e shqiptuar të dënimit me burgim. Kërcënimi i tillë si dhe presionet e vazhdueshme të gjeneruar nga prania e F.T. në afërsinë e tyre, i ka detyruar ankuesit që ta braktisin fshatin ku kanë jetuar dhe shtetin e thirrur në përgjegjësi.

Qeveria ka theksuar se përmbarimi i dënimit me burgim, masë kjo e cila i është shqiptuar F.T. është prolonguar për shkakun se tetë muaj nuk është përcaktuar gjykatësi për përmbarim të sanksioneve, i cili do të vepronte në lidhje me këtë lëndë. Fakti se F.T. vetëm për një kohë të shkurtër ka qenë i ndaluar në paraburgim, ka sugjeruar mos ekzistimin e rrezikut për

ndikimin e tij mbi hetimet ose për ndikime të mundshme mbi dëshmitarët. Ai ka vazhduar që të jetojë në të njëjtën shtëpi dhe sipas materialeve të disponueshme, nuk ekziston asgjë që do të sugjeronte se ai ka paraqitur kërcenim për ankuesit. Në mënyrë plotësuese, ankuesit nuk janë ankuar para organeve kombëtare se F.T. u është kërcënuar ose se ka bërë diçka tjetër, që do ti rrezikonte të njëjtit. Përskaj kësaj, ankuesit ka lëshuar që ti argumentojnë pohimet e tyre se F.T. ka paraqitur një kërcënim real mbi jetën dhe sigurinë e tyre dhe se frika e tyre se ai përsëri do të tentoj të sulmoj në shtëpinë e tyre ka qenë reale. Në fund, Qeveria ka konsideruar se është e mundur që F.T. të kthehet në njëjtën shtëpi pas vuajtjes së dënimit me burg. Në mungesë të çfarëdo veprimi të mundshëm dhe real kundër ankuesit, vetë prania e F.T. në të njëjtin fshat nuk ka mundur që të interpretohet si kërcënim dhe rrezik në lidhje me të drejtat e tyre që pasojnë nga Konventa.

Vlerësimet dhe arsyetimet e dhëna nga Gjykata

Gjykata përsërit faktin se neni 2 u imponon obligimin shteteve që të sigurojnë të drejtën e jetës përmes implementimit të sistemit të dispozitave penale – juridike të cilat do të mundësonin anulimin efikas të kërcënimeve mbi jetën, të përkrahura nga mekanizmi për zbatim të ligjit, me qëllim të parandalimit, pengimit dhe dënimit të atyre personave që kanë shkelur dispozitat e tilla. Veprimi në pajtim me obligimet e shtetit, që pasojnë nga neni 2 i Konventës, supozon që sistemi juridik vendor të demonstroj kapacitetin e tij për implementim dhe zbatim të legjislativit penal ndaj atyre personave që në kundërshtim me ligjin i kanë marrë dikujt jetën.

Duke iu rikthyer rastit konkret, gjykata konsideron se veprimet e S.G. dhe F.T. kanë qenë të natyrës së tillë, që privimi nga liria i këtyre personave, përkatësisht dënimi me burgim ka qenë i domosdoshëm, në bazë të rrezikut që ata kanë paraqitur për sigurinë publike.

Rasti, ashtu siç është elaboruar nga ana e ankuesve, ka të bëjë me prolongimin e zbatimit të dënimit me burgim të personit F.T., dhe për këtë sipas tyre, në tërësi është përgjegjëse shteti i thirrur në përgjegjësi.

Në lidhje me këtë, Gjykata konstaton se F.T. nuk ka filluar vuajtjen e dënimit me burgim deri më 11 korrik të vitit 2014, gjë që është më gjatë se 18 muaj pas hyrjes në fuqi të aktgjykimit gjykues. Gjykata sajoi konkludimin se tre shkresat e gjykatësit për përmbarim të sanksioneve, kanë mbetur pa përgjigje dhe se me këtë ka ekzistuar mungesë e koordinimit në mes dy seksioneve të gjykatës së njëjtë.

Fitohet përshtypja se në mes 20 majit të vitit 2013 dhe 27 marsit të vitit 2014, kur është përcaktuar një akt i ri udhëzues, nga ana e organeve kompetente, nuk janë ndërmarrë kurrfarë masa për përmbarim të vendimit të plotfuqishëm të datës 26 nëntor të vitit 2012. Sipas Qeverisë, në këtë periudhë nuk ka pasur gjykatës për përmbarim të sanksioneve i cili do të vepronte në lidhje me këtë lëndë konkrete.

Gjykata vëren se legjislativi vendor parashikon urgjencën e procedurës për udhëzim të vuajtjes së dënimit me burg. Kërkesa për efikasitet të hetimeve penale, nga neni 2 i Konventës, gjithashtu mund të interpretohet si modus sipas të cilit shteteve u imponohet obligimi që ti përmbarojnë aktgjykimet e tyre të plotfuqishme, pa prolongime të pa arsyeshme. Kjo është kështu, meqenëse përmbarimi i sanksioneve të shqiptuara në kontekst të së drejtës për jetë, duhet të konsiderohet si pjesë integrale e obligimit procedural të shtetit që pason nga neni i lartpërmendur.

Në bazë të fakteve të këtij rasti, Gjykata konsideron se organet shtetërore të thirrur në përgjegjësi, nuk i kanë kushtuar vëmendjen e duhur procedurës së përmbarimit të dënimit me burg, masë kjo e cila i është shqiptuar F.T. Prolongimet e theksuara më lartë, të cilët në tërësi kanë të bëjnë me organet kompetente, nuk mund të konsiderohen si racionale. Rrethanat specifike të këtij rasti, kanë kërkuar nga organet kompetente, një reagim më të shpejtë. Për këto shkaqe, Gjykata konsideron se sistemi i shtetit të thirrur në përgjegjësi në lidhje me përmbarimin e dënimeve me burgim, nuk është dëshmuar si efikas në këtë rast konkret. Prolongimet pa arsye të përmbarimit të aktgjykimit nuk kanë qenë në pajtim me obligimet e shtetit që pasojnë nga neni 2 i Konventës, pavarësisht nga fakti se vallë F.T., pasi që ka qenë i gjykuar, ka demonstruar çfarëdo lloj të hostilitetit, përkatësisht të raportit armiqësorë me ankuesit.

Duke i marrë parasysh faktet e lartpërmendura, GJEDNJ ka sajuar konstatimin e shkeljes së aspekteve procedurale lidhur me nenin 2 të KEDNJ. Duke pasur parasysh gjetjet e tilla, Gjykata ka miratuar aktgjykimin se shteti i paditur duhet ti paguaj ankuesve me nga 5.000 euro si dëmshpërblim të dëmit të natyrës jo materiale, si dhe 2.420 euro për mbulim të shpenzimeve dhe pagave të gjeneruar në lidhje me procedurën para GJEDNJ.

Selmani dhe të tjerët kundër Republikës së Maqedonisë – A. nr. 67259/14, Aktgjykimi i GJEDNJ nga 9 shkurti i vitit 2017

Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut (GJEDNJ) më 09.02.2017 solli aktgjykimin në lidhje me rasti – Selmani dhe të tjerët kundër Republikës së Maqedonisë. Ankuesit janë ankuar në bazë të nenit 6 të Konventës për mos mbajtjen e seancës dëgjimore gjatë procedurës para Gjykatës Kushtetuese dhe në pajtim me nenin 10, në lidhje me largimin e dhunshëm të tyre nga galeria e Kuvendit, prej nga ata kanë raportuar për seancën plenare të kuvendit më datën 24 dhjetor të vitit 2012.

Përkatësisht, ankesa ka qenë e parashtruar më 3 tetor të vitit 2014, nga ana e gjashtë nënshtetasve nga Maqedonia, z. Naser Selmani, z. Toni Angellovski, zonja Biljana Dameska, zonja Frosina Fakova, zonja Snezhana Llupevska dhe zonja Natasha Stojanovska (“ankuesit”).

Faktet e rastit

A. Ndodhitë në Kuvend më datën 24 dhjetor të vitit 2012.

Më 24 dhjetor të vitit 2012, është mbajtur procedura parlamentare për Ligjin për buxhetin e vitit 2013. Ankuesit të cilët kanë qenë gazetarë të akredituar që të raportojnë nga kuvendi kombëtarë, së bashku me gazetarët tjerë, kanë raportuar nga galeria e Kuvendit, e cila gjendet mbi sallën kuvendare (“sallën”), ku kanë qenë të pranishëm deputetët e Kuvendit (“deputetët”). Gjatë procedurës së lartpërmendur, deputetët e

opozitës i janë afruar kryetarit të Kuvendit ("kryetarit") dhe kanë filluar që të bëjnë zhurmë, mes tjerave edhe duke trokitur në tryezën tij. Shkurt pas kësaj, sigurimi i kuvendit ka intervenuar në sallën e kuvendit. Ata e kanë larguar kryetarin e Kuvendit nga salla dhe me dhunë kanë filluar që ti largojnë edhe deputetët e opozitës. Në të njëjtën kohë, zyrtarët tjerë të sigurimit kanë depërtuar në galeri dhe kanë filluar që ti largojnë ankuesit dhe gazetarët tjerë. Derisa disa gazetarë kanë vepruar në pajtim me udhëzimet e dhëna, ankuesit kanë refuzuar që të largohen dhe të njëjtit janë larguar me dhunë nga galeria.

Në të njëjtën kohë, dy grupe të kundërshtuara mes vete janë mbledhur para ndërtesës së Kuvendit.

B. Ndodhitë e më vonshme

1. Reagimi publik i kryetarit të Kuvendit

Në shkresën e dorëzuar më 26 dhjetor të vitit 212 të drejtuar deri te mediumet, kryetari i Kuvendit mes tjerave ka deklaruar:

„Duke i pasur parasysh paralajmërimet se opozita nuk do të lejojë që të miratohet Ligji për buxhetin dhe se do të mbahen protesta dhe incidente, në pajtim me nenin 43 të Ligjit për Kuvendin, nga shërbimi i sigurimit pranë Kuvendit kërkova që të siguroj punë të normalizuar gjatë seancës. Do të doja që të theksoj faktin se shërbimi i sigurimit pranë kuvendit, i përcakton dhe zbaton masat e domosdoshme të cilat duhet të ndërmerren...duke pasur parasysh faktin se galeria është pjesë e sallës për seancat plenare, sigurimi i kuvendit ka sajuar vlerësimet se galeria duhet të zbrazet me qëllim që të evitohen incidentet e përmasave më të mëdha.

Si kryetar i Kuvendit, shpreh keqardhjen që u soll një masë e tillë në lidhje me gazetarët..."

2. Argumentet e Sektorit për kontrollim të brendshëm dhe për standarde profesionale ("SKBSP") pranë Ministrisë për punë të brendshme.

Më 26 dhjetor të vitit 2012, Shoqata e gazetarëve (e përfaqësuar nga kryetari i sajë, ankuesi i parë) ka dorëzuar shkresën deri te "SKBSP" duke

konstatuar se largimi i dhunshëm i gazetarëve ka prezantuar shkeljen e të drejtave të tyre në pajtim me nenin 10 të Konventës. Në shkresën e dorëzuar, gazetarët kanë kërkuar që të iniciohet procedura kundër personave përgjegjës që kanë lejuar dhe që kanë zbatuar largimin e tyre nga galeria.

Në shkresën e dorëzuar më 6 janar të vitit 2013, "SKBSP" i ka njoftuar ankuesit se ata kanë vepruar në pajtim me Ligjin për Kuvendin dhe në kërkesë të Kryetarit të Kuvendit. Në galerinë ka qenë i pranishëm një deputet i cili ka qenë i përfshirë në cenimin e rendit në sallën e kuvendit si dhe persona të tjerë të cilët kanë mundur që ti pengojnë gazetarët gjatë realizimit të detyrave të tyre. Ata i kanë lutur gazetarët që ta braktisin galerinë dhe të vazhdojnë që ti përcjellin ndodhitë e mëtutjeshme nga qendra informative. Pjesa më e madhe e gazetarëve e kanë kuptuar seriozitetin e situatës dhe kanë vepruar në pajtim me udhëzimet e dhëna. Por, një grup më i vogël i personave në galeri, duke i përfshirë këtu edhe "ankuesit" janë konfrontuar me sigurimin e kuvendit dhe kanë manifestuar rezistencë aktive dhe pasive. Si rezultat i kësaj, një zyrtarë i sigurimit ka përfituar lëndime në pjesën e këmbës.

"SKBSP" ka sajuar konkludimin se autorizimet e zbatuara nga organet e detyruara për zbatimin e ligjit, nuk i kanë tejkaluar kufijtë e pranueshme dhe se nuk është shfrytëzuar fuqi e tepruar.

3. Konstatimet e komisionit "ad hok" në lidhje me hetimet

Më 14 qershor të vitit 2013, kryetari i shtetit ka formuar komisionin "ad hok" për ti hetuar ngjarjet në Kuvendin kombëtarë të datës 24 dhjetor të vitit 2012. Komisioni ka qenë i përbërë nga pesë anëtarë kombëtarë, prej tyre dy deputet. Në këtë komision janë përfshirë edhe dy vrojtues të shteteve të huaja, të emëruar nga Bashkimi Evropian. Më 26 gusht të vitit 2013, komisioni ka përpiluar një raport ekspertësh, dhe pjesa relevante e tij thotë:

"V-Kualifikime juridike"

... Mos ekzistimi i udhëzimeve përkatëse për ballafaqim me situata të tilla, duke përfshirë këtu edhe mos ekzistimin e strategjisë për veprim

me mediumet në gjendje krize, rezultoi me situatën në të cilën gazetarët ishin të larguar nga galeria e kuvendit, me këtë janë lënduar të drejtat e tyre për lirinë e informimit dhe transparenca publike në punën e Kuvendit. Kuvendi, në veçanti duhet të mbaj llogari për transparencën për nga aspekti i lirisë së mediumeve që të njoftojnë dhe gjatë kësaj Kuvendi duhet ti zbatoj praktikat më të mira evropiane në këtë fushëveprim...".

C. Procedura para Gjykatës Kushtetuese

Ankuesit kanë parashtruar ankesë kushtetuese deri te Gjykata kushtetuese në të cilën ata janë ankuar në lidhje me shkeljen e të drejtave të tyre në pajtim me nenin 10 të Konventës. Ata kanë deklaruar se debati kuvendar dhe ngjarjet që kanë pasuar në lidhje me miratimin e buxhetit shtetërorë, kanë qenë ngjarje me interes të posaçëm publik. Intervenimi i sigurimit kuvendar si dhe largimi i ankuesve nga galeria nuk ka qenë as masë "ligjore" e as "masë e domosdoshme në një shoqëri demokratike". Në lidhje me ligjshmërinë e masave të ndërmarra, ankuesit kanë theksuar se neni 43 i Ligjit nuk mund të interpretohet se mundëson largimin e dhunshëm të gazetarëve nga galeria, nga ana e sigurimit të kuvendit. Në çdo rast, kjo dispozitë nuk ka qenë mjaftueshëm precize. Për sa i përket domosdoshmërisë së masave, ata kanë argumentuar se në kohën kritike ata kanë qenë në galeri dhe se nuk kanë pasur kontakte me kryetarin e Kuvendit ose me deputetët. Sipas kësaj, ata as që kanë kontribuar, e as që kanë qenë në gjendje që të kontribuojnë në drejtim të cenimi të rendit në sallë. Përskaj kësaj, ata i kanë kontestuar argumentet e dhëna nga "SKBSP" se gjoja ka pasur persona të pa autorizuar në galeri dhe se protestat para ndërtesës së kuvendit e kanë arsyetuar largimin e dhunshëm të tyre. Ata kanë kërkuar nga gjykata që të mundësoj seancën dëgjimore në pajtim me nenin 55 të Rregullores së Gjykatës Kushtetuese dhe të konstatohen shkeljet e nenit 16 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të Konventës.

Në seancën e mbajtur më 16 prill të viti 2014 në mungesë të palëve, Gjykata kushtetuese e ka refuzuar ankesën e ankuesve.

A. Aspekti i lejueshmërisë

Zbatimi i nenit 6, paragrafi 1 të Konventës

Qeveria është prononcuar se "nuk ka parashtresa në lidhje me zbatimin e nenit 6, paragrafi 1 të Konventës, për nga aspekti i procedurës para Gjykatës kushtetuese."

B. Aspekti i qëndrueshmërisë

Parashtresat e palëve

(a) Ankuesit

Ankuesit theksuan se në rastin e lartpërmendur, Gjykata kushtetuese nuk ka qenë e thirrur që të vendos vetëm për çështjet juridike. Ka pasur disa çështje kontestuese faktike, për të cilat është dashur që të mbahet seanca dëgjimore në prani të ankuesve dhe përfaqësuesve të tyre juridik. Çështjet kanë qenë në lidhje me mënyrën në të cilën ankuesit i kanë larguar nga galeria e kuvendit, në veçanti dilema se vallë shkaqet për largimin e tyre u janë sqaruar, kush e ka lejuar veprimin e nëpunësve të sigurimit, nivelin e fuqisë të cilën ata e kanë shfrytëzuar dhe se vallë në këtë incident ka qenë i lënduar ndonjëri prej nëpunësve të sigurimit. Çështjet tjera të kontestuara faktike, kanë qenë në lidhje me (pa) mundësinë që ankuesit ta përcjellin incidentin në sallën e kuvendit si dhe rreziku mbi sigurinë, që ka imponuar, ashtu siç ka konstatuar Gjykata kushtetuese, largimin e tyre nga galeria.

(b) Qeveria

Qeveria është thirrur në pozitën e posaçme të Gjykatës kushtetuese dhe ka konsideruar se kjo gjykatë nuk është as gjykatë e rregullt, e as gjykatë që përcakton gjendjet faktike. Seanca gjyqësore, për nga aspekti i ankesave të caktuara kushtetuese, kryesisht i ka përfshirë çështjet juridike, jo edhe përcaktimin e gjendjes faktike, me përjashtim të gjendjeve të cilat nuk janë kontestuese në mes palëve.

Qeveria theksoi se neni 55 i Rregullores së Gjykatës kushtetuese, nuk i thekson rastet në të cilat kërkohet nga gjykata që të mbaj seancën dëgjimore publike. Sipas kësaj, gjykata ka gëzuar të drejtën diskrete që të vendos se vallë do të mbahet seanca dëgjimore publike për përcaktim

të fakteve kontestuese. Nga viti 2001, Gjykata kushtetuese ka mbajtur vetëm katër seanca publike dëgjimore, në procedurat që kanë qenë në lidhje me ankesave të caktuara kushtetuese.

Në rastin konkret, Gjykata kushtetuese e ka bazuar vendimin e saj në bazë të parashtresave me shkrim si dhe në bazë të dokumenteve të dorëzuara nga ana e ankuesve dhe nga Kuvendi, të cilët kjo gjykatë i ka vlerësuar si të mjaftueshme për përcaktimin e fakteve relevante. Për palët nuk ka qenë kontestuese fakti se ankuesit janë larguar nga galeria. Çështja kryesore që është dashur që të zgjidhet ka qenë çështja e natyrës juridike, përkatësisht fakti se vallë largimi në mënyrë të tillë ka paraqitur shkeljen e së drejtës së ankuesve, të drejtën e shprehjes së lirë. Për këto arsye, duke pasur parasysh faktin se palët vetëm do të përsërisnin atë që e kanë theksuar në parashtresat me shkrim të dorëzuara nga ana e tyre, mbajtja e seancës dëgjimore për procedurën e kontestuar, nuk do të kontribuonte për aspektin e drejtësisë, e as që do të shërbente për ndonjë qëllim të dobishëm. Përkundrazi, me këtë vetëm do të prolongohej procedura dhe një gjë e tillë do të ishte në kundërshtim me parimet e leverdisë ekonomike dhe të efikasitetit. Përfundimisht, palët nuk kanë qenë të penguara që ti parashtrojnë dëshmitë dhe ti elaborojnë argumentet e tyre.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata thekson faktin se në procedurën para gjykatës së instancës së parë dhe të vetme, e drejta e "debatit publik" sajon të drejtën e "debatit dëgjimorë", sipas nenit 6, paragrafi 1, me përjashtim të rasteve të ekzistimit të rrethanave të veçanta, të cilët do të arsyetonin mos mbajtjen e një debati të tillë gjyqësorë.

Duhet të theksohet fakti se rasti i ankuesve ka qenë i shqyrtuar vetëm para Gjykatës kushtetuese, e cila ka vepruar si gjykatë e instancës së parë dhe të vetme. Asnjë organ tjetër gjyqësorë nuk e ka shqyrtuar këtë rast para Gjykatës kushtetuese. Kjo ka qenë në kompetencë të kësaj gjykate dhe ajo

ka prezantuar trupin e vetëm i cili ka vendosur me aspektet meritore të këtij rasti.

Rasti ka të bëjë me ankesën e ankuesve se me largimin e dhunshëm të tyre nga galeria e Kuvendit, u është shkelur e drejta e lirisë së shprehjes. Gjykata nuk konsideron se në këtë rast kemi të bëjmë vetëm me çështjet juridike. Përkundrazi, konkluzionet e Gjykatës kushtetuese në lidhje me domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e masës së kontestuar, janë mbështetur në çështje faktike, të cilat është dashur që gjykata ti konstatoj. Edhe pse largimi i ankuesve nga galeria e Kuvendit, vetvetiu nuk është kontestuese në mesin e palëve, vendimi i Gjykatës kushtetuese është bazuar mbi faktet të cilat ankuesit i kanë kontestuar, dhe të cilët kanë qenë relevante për konkluzionin përfundimtarë të këtij rasti. Këto çështje nuk kanë qenë as të natyrës faktike, e as thjeshtë të natyrës së pastër juridike.

Për këto arsye, ankuesit kanë pasur të drejtën e seancës dëgjimore para Gjykatës kushtetuese.

Duke pasur parasysh lartpërmendurën, Gjykata konsideron se nuk kanë ekzistuar rrethana përjashtuese me të cilat do të mund të arsyetohet mos mbajtja e seancës dëgjimore.

Sipas kësaj, në këtë rast ekziston shkelja e nenit 6, paragrafi 1 të Konventës në lidhje me mos mbajtjen e seancës dëgjimore gjatë procedurës para Gjykatës kushtetuese.

II. SHKELJET E THEKSUARA TË NENIT 10 TË KONVENTËS

Ankuesit janë ankuar se largimi i tyre nga galeria e kuvendit, paraqet shkeljen e të drejtave të tyre në pajtim me nenin 10 të Konventës.

A. Aspekti i lejueshmërisë

1. Statusi i “viktimës” së ankuesve

(a) Parashtresat e dorëzuara nga palët

Qeveria është prononcuar se konstatimet e komisionit "ad hok" për hetimin e këtij rasti, anëtarët e së cilët kanë qenë persona të pavarur krahas personave të përfshirë në incidentin e datës 24 dhjetor të vitit 2002, kanë nënkuptuar një kompensim përkatës dhe të mjaftueshëm për ankuesit. Sipas kësaj, ata e kanë humbur statusin e "viktimës" krahas argumentimeve ankuese sipas kësaj baze.

Ankuesit i kanë kontestuar argumentet e Qeverisë. Komisioni për hetime, nuk ka qenë organ shtetërorë, por një komision ekspertësh "ad hok". Fakti se ky komision ka konstatuar shkeljen e së drejtës së tyre të shprehjes së lirë, nuk ka mundur që të konsiderohet si konfirmim nga ana e organeve shtetërore. Përskaj kësaj, zyrtarët kombëtarë nuk kanë ndërmarrë kurrfarë mase për evitimin e shkeljes së lartpërmendur.

(b) Vlerësimi i Gjykatës

Ashtu siç ka vlerësuar Gjykata në më shumë raste, vendimi ose masa në dobi të ankuesit, parimisht nuk mjafton që ai ose ajo të humb statusin e "viktimës" për qëllimet e nenit 34 të Konventës, me përjashtim të rasteve nëse zyrtarët nuk kanë konfirmuar, në mënyrë eksplicite ose esenciale, dhe më pas kanë përcaktuar kompensimet përkatëse për shkeljen e Konventës.

Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se në lidhje me ndodhitë konkrete, kryetari i shtetit ka formuar komisionin e hetimeve, në trajtë të trupit "ad hok". Komisioni ka përpiluar raport për ngjarjet e datës 24 dhjetor të vitit 2012, në të cilin mes tjerave ka vlerësuar se "gazetarët janë larguar nga galeria e kuvendit, gjë që paraqet shkeljen e të drejtës së lirisë së informimit të opinionit". Por, Gjykata konsideron se kjo nuk paraqet kurrfarë kompensim për dëmin e shkaktuar, ashtu siç kërkohet në praktikën e saj gjyqësore.

Si konkludim, Gjykata konsideron se ankuesit mund të pohojnë se janë "viktima" në kuptim të nenit 34 të Konventës.

2. Mos shfrytëzimi i mjeteve vendore juridike

(a) Parashtresat e palëve

Qeveria ka argumentuar se ankuesit nuk i kanë shfrytëzuar të gjitha mjetet efektive juridike. Në veçanti, ata nuk kanë kërkuar kompensim të dëmit sipas rregullave të përgjithshme për kundërvajtjet, të parapara me Ligjin për marrëdhënie obligative. Përskaj kësaj, ata nuk kanë iniciuar procedurën penale kundër shkaktarëve të panjohur. Në fund, ata nuk i kanë theksuar argumentimet e tyre ankuese para Gjykatës administrative në pajtim me Ligjin për kontestet administrative.

Ankuesit kanë kontestuar se mjetet juridike të cilat i udhëzon Qeveria, janë efikase në teori dhe në praktikë. Kërkesa për kompensim të dëmit, nuk do të kishte kurrfarë gjase të suksesit, nëse merret parasysh fakti i mos ekzistimit të vërtetimit të mëparshëm për shkeljen e të drejtave të tyre, sipas kësaj baze. Përskaj kësaj, nuk ka ekzistuar ndonjë shembull i praktikës vendore gjyqësore në të cilin gjykatat civile kanë ndarë dhe përcaktuar dëmshpërblime për shkeljen e së drejtës së shprehjes së lirë nga ana e personave zyrtarë. Qëndrime të ngjashme kanë të bëjnë edhe me mjetet penale juridike për kompensim të dëmeve. Përskaj kësaj, Gjykata kushtetuese nuk e ka refuzuar ankesën kushtetuese për shkak të mos shfrytëzimit të plotë të mjeteve juridike. Në fund, nëse kanë qenë në disponin më shumë se një prej mjeteve efikase juridike, nga ankuesit është kërkuar që të shfrytëzojnë vetëm njërin prej tyre.

(b) Vlerësimet e Gjykatës

Gjykata përsërit faktin se kur shfrytëzohet një mjet juridik, nuk nevojitet shfrytëzimi i mjetit tjetër juridik, që në esencë përfshin qëllimin e njëjtë. Më pas, Gjykata konsideron se do të ishte tejet formalistike që të kërkohet nga ankuesit të shfrytëzojnë mjete juridike, për një çështje për të cilën as Gjykata kushtetuese nuk i ka obliguar që ta shfrytëzojnë.

Sipas kësaj, ankesa nuk mund të shpallet si e pa lejueshme për shkak të mos shfrytëzimit të mjeteve vendore juridike, në kuptim të nenit 35 të Konventës.

3. Konkluzion

Gjykata sajoi konkludimin se ankesa e ankuesve në këtë bazë nuk është e pa bazuar në mënyrë evidente, në kuptim të nenit 35 paragrafi 3 (a)

të Konventës. Nuk është përcaktuar asnjë bazë tjetër për shpalljen e ankesës si të pa lejuar. Për këto arsye, ankesa duhet të shpallet si e lejueshme.

B. Aspekti i qëndrueshmërisë

1. Parashtresat e palëve

(a) Ankuesit

Ankuesit kanë parashtruar argumentet se largimi i tyre nga galeria e kuvendit nuk ka qenë "në pajtim me ligjin". Në lidhje me këtë argumentim ata theksuan se Ligji për Kuvendin nuk ka qenë i parashikueshëm. Më pas, ata kanë ofruar argumentimet se nuk ka ekzistuar "nevoja urgjente shoqërore" për largimin e tyre. Ata nuk kanë qenë në rrezik e as që janë ndjerë se janë të rrezikuar nga situata.

(b) Qeveria

Qeveria konsideron se ka qenë i domosdoshëm largimi i ankuesve nga galeria, meqenëse ka sunduar një atmosferë e tensionuar në sallë dhe jashtë kuvendit, ku ka pasur protesta të dhunshme dhe të pa parashikuara, dhe e gjithë kjo ka qenë në pajtim me Konventën. Masa është mbështetur në nenin 43 të Ligjit për Kuvendin, që i jep të drejtën kryetarit të Kuvendit që ti urdhëroj sigurimit të kuvendit të normalizoj rendin me qëllim që debati kuvendar të mund të vazhdoj. Kjo masë nuk ka qenë e zbatuar me qëllim të pengimit të tyre që të informojnë në lidhje me seancën kuvendare. Kjo masë ka qenë e domosdoshme duke pasur parasysh faktin e cenimit në rrjedhë të rendit, gjë që ka eskaluar me hedhjen e gjësendeve në sallë dhe në drejtim të galerisë, si pjesë e sallës. Vlerësimet e rreziqeve mbi sigurinë, që janë sajuar në suaza të margjinës së diskrecionit shtetërorë, kanë rezultuar me nevojën që galeria të zbrazet dhe me këtë të evitohen çfarëdo lloj i kërcënimeve mbi integritetin fizik të gazetarëve.

2. Vlerësimi i Gjykatës

(a) Ekzistimi i pengimit

Ekziston qëndrimi i përbashkët i palëve, dhe Gjykata pajtohet se largimi i ankuesve nga galeria e kuvendit, prej nga ata kanë raportuar për seancën kuvendare si dhe incidentet e mëvonshme në sallë, kanë prezantuar "pengimin" e së drejtës së tyre të shprehjes së lirë, në kuptim të nenit 10, paragrafi 1 të Konventës.

Gjykata duhet të hulumtojë se vallë pengimi i llojit të tillë ka qenë "i përcaktuar me ligj", për shkak të realizimit të një ose më shumë qëllimeve legjitime në kuptim të paragrafit 2 të nenit 10, dhe se një masë e tillë "ka qenë e domosdoshme në suaza të një shoqërie demokratike".

(b) Vallë pengimi ka qenë i përcaktuar me ligj

Gjykata përsërit faktin se shprehja "e përcaktuar me ligj" në nenin 10, paragrafi 2 jo vetëm që kërkon që masa e kontestuar të posedoj bazë juridike në suaza të drejtësisë vendore, por kërkon që ajo të jetë në përputhshmëri me cilësinë e ligjit në fjalë, i cili do të duhet të jetë në qasje për personin e cenuar dhe i parashikueshëm për nga aspekti i efekteve të tij.

Sipas kësaj, një normë nuk mund të konsiderohet si "ligj" në kuptim të nenit 10, paragrafi 2, vetëm nëse nuk është i formuluar me precizitet të mjaftueshëm që ti mundësoj qytetarit që ta rregulloj sjelljen e tij; qytetari duhet të jetë në gjendje, nëse nevojitet edhe me këshill përkatës, ti parashikon, deri në nivel i cili do të jetë racional në suaza të rrethanave, pasojat që mund ti shkaktoj një veprim i caktuar. Këto pasoja nuk është e thënë që të jenë të parashikueshme me siguri absolute. Derisa preferohet siguria, ajo mund të sjell rigjiditet tej mase, kurse ligji duhet të jetë në gjendje që të mbaj hapin me rrethanat e ndryshueshme. Sipas kësaj, shumë ligje në mënyrë të pa evituar janë të formuluar me terminë të cilat në masë më të madhe ose më të vogël, janë të paqarta, dhe interpretimi dhe zbatimi i të cilëve është çështje e praktikës.

Në rastin konkret, duhet të theksohet fakti se në vendimin e tij të datës 16 prill të vitit 2014, Gjykata kushtetuese ka sajuar konkludimin se largimi i ankuesve nga galeria e kuvendit ka qenë në pajtim me nenin 43 të Ligjit për Kuvendin si dhe me nenet 91-94 të Rregullores së Kuvendit.

Sipas këtyre dispozitave, kryetari i Kuvendit ka qenë personi përgjegjës për mbajtjen e rendit gjatë kohës së mbajtjes së seancave kuvendare. Në fakt, ai i ka urdhëruar shërbimit special për sigurimin e Kuvendit, që të marrë masa që të rikthej rendin. Këto dispozita janë zbatuar mbi të gjithë pjesëmarrësit në procedurën gjyqësore, të cilët, sipas interpretimit të Gjykatës kushtetuese i kanë përfshirë edhe gazetarët në galeri.

Gjykata përsërit faktin se së pari organet kombëtare, në veçanti gjykatat janë organet të cilat e interpretojnë dhe zbatojnë të drejtën vendore. Edhe pse, rregullat e lartpërmendura nuk kanë përfshirë në vete dispozita eksplicite të cilat sigurimit i kanë dhënë të drejtën që ti largojnë gazetarët e akredituar nga galeria e kuvendit, nuk është jo racionale se autorizimet e tilla kanë qenë karakteristike për funksionimin e rregullt të Kuvendit. Gjykata nuk gjen kurrfarë indikacione se konstatimet e Gjykatës kushtetuese kanë qenë të arbitruara ose jo racionale në mënyrë të dukshme. Sipas kësaj, Gjykata nuk konsideron se ankuesit nuk kanë mundur që të parashikojnë, deri në masë racionale, se intervenimi i sigurimit mundet, në rrethana të caktuara, të ndikoj mbi mundësinë që gazetarët të raportojnë nga galeria.

Përkundrazi, Gjykata konsideron se dispozitat relevante të Ligjit për Kuvendin dhe Rregullorja e kuvendit, të cilat kanë qenë në qasje për opinionin, e kanë plotësuar nivelin e kërkuar të precizitetit dhe të parashikueshmërisë dhe se, sipas kësaj, pengimi ka qenë "i përcaktuar me ligj".

(c) Vallë pengimi ka pasur qëllim legjitim

Qeveria ka pohuar se pengimi ka pasur për qëllim që të mundësohet siguria publike, që të pengohet çrregullimi i rendit dhe të mbrohen ankuesit.

Gjykata konsideron se pengimi ka pasur për qëllim ofrimin e sigurisë publike dhe pengimin e çrregullimeve të rendit. Sipas kësaj, çështja kryesore që mbetet të përcaktohet në këtë rast, është çështja se vallë pengimi i kontestuar ka qenë "i domosdoshëm në një shoqëri demokratike".

(ç) „E domosdoshme në një shoqëri demokratike”

(d) Parime të përgjithshme

Parimet e përgjithshme në lidhje me domosdoshmërinë e pengimit të lirisë së shprehjes janë të përmbledhura në rastin “Delfi AS” me sa vijon:

“(i) Liria e shprehjes paraqet njërin prej themeleve kryesore të një shoqërie demokratike, dhe njërin prej parakushteve themelore të përparimit dhe të vetë përmbushjes së çdo individi. Në pajtim me paragrafin 2 të nenit 10, e njëjta ka të bëjë jo vetëm me “informacionet” ose “idetë” që janë pranuar pozitivisht ose të cilat konsiderohen si jo fyese ose si çështje të indiferencës, por edhe me ato që ofendojnë, shokojnë ose shqetësojnë. Të tilla janë kërkesat e pluralizmit, tolerancës dhe mendimit të lirë, pa të cilat nuk mund të ekzistoj “shoqëria demokratike”. Siç është paraparë në nenin 10, kjo liri është lëndë e përjashtimeve, të cilat....duhet, prapëseprapë të interpretohen rigorozisht, dhe nevoja për çfarëdo lloj kufizime, duhet të përcaktohet në mënyrë të bindshme...

(ii) Termi “i domosdoshëm”, në suaza të kuptimit të nenit 10, paragrafi 2, implikon ekzistimin e “nevojës urgjente shoqërore”. Shtetet – nënshkruese posedojnë një margjinë të caktuar të respektimit të normës së tillë gjatë vlerësimit se vallë ekziston një nevojë e tillë, por një gjë e tillë është e pandashme dhe ngushtë e ndërlidhur me mbikëqyrjen evropiane, duke e përfshirë këtu edhe legjislativin dhe vendimet për zbatimin e tij, bile edhe të atyre vendimeve të dhëna nga gjykatat e pavarura. Sipas kësaj, Gjykata është e autorizuar që të sjell vendim përfundimtarë për atë se vallë “kufizimi” mund të harmonizohet me lirinë e shprehjes, të garantuar dhe të mbrojtur me nenin 10.

(iii) Detyra e Gjykatës, gjatë ushtrimit të kompetencës së saj mbikëqyrëse, nuk është marrja e rolit të organeve kompetente shtetërore, por shqyrtimi se vallë janë në pajtim me nenin 10, vendimet që ata i kanë miratuar në pajtim me autorizimet e tyre për vlerësim. Kjo nuk nënkupton faktin se mbikëqyrja është e kufizuar në aspektin e përcaktimit se vallë shteti i paditur e zbaton të drejtën e saj diskrete në mënyrë racionale, me kujdes dhe me vullnet të mirë; ajo që Gjykata duhet të bëjë është shqyrtimi i

pengesës së ankuar, në dritën e rastit marrë si një tërësi dhe të përcaktoj se vallë një veprim i tillë ka qenë "proporcional me qëllimin legjitim dhe se vallë shkaqet e ofruara nga ana e pushtetit kombëtarë e që janë në lidhje me arsyetimin e tij, janë "relevante dhe të mjaftueshme"... Gjatë kësaj, Gjykata duhet të bindet se pushteti kombëtarë po zbaton standarde që janë në pajtim me parimet e përfshira me nenin 10 dhe, mbi gjithë këtë, se të njëjtit bazohen mbi vlerësimin e pranueshëm të fakteve relevante...".

Gjykata më pas thekson funksionin esencial që kanë mediumet në një shoqëri demokratike. Edhe pse të njëjtit nuk guxojnë ti tejkalojnë kufijtë e përcaktuar, prapëseprapë detyrë e tyre është të raportojnë – në mënyrë konsistente me obligimet e tyre dhe me përgjegjësitë – informacionet dhe idetë, për të gjitha çështjet që janë në interes publik. Jo vetëm që mediumet kanë për detyrë që të raportojnë informacionet dhe idetë e tilla, por edhe opinioni i gjerë ka të drejtën që ti pranojë këto informacione.

(ii) Zbatimi i parimeve të përgjithshme në lidhje me rastin konkret

Gjykata përsërit faktin se kuvendet kanë të drejtën e reagimit në rastet kur deputetët do të përfshihen në aktivitete për çrregullimin e rendit, duke penguar në këtë mënyrë funksionimin e normalizuara të shtëpisë ligjvënëse. Kjo për shkakun se debati i normalizuar në Kuvend, në instancë të fundit i shërben procesit politik dhe të procesit legjislativ, interesave të të gjithë faktorëve të ligjvënies, duke u mundësuar në këtë mënyrë pjesëmarrjen në kushte të barabarta në seancën plenare, si dhe të interesave të shoqërisë marrë si një tërësi.

Gjykata konsideron se çrregullimi i rendit në sallën kuvendare dhe mënyra se si organet janë ballafaquar me këtë situatë, kanë qenë çështje me interes legjitim publik. Për këto arsye, mediumet kanë pasur për detyrë që të raportojnë informacione për këtë ngjarje, dhe opinioni ka pasur të drejtën që ti pranojnë këto informacione. Në lidhje me këtë, Gjykata udhëzon në praktikën e sajë gjyqësore, në lidhje me rolin esencial të mediumeve në drejtim të sigurimit të informacioneve për veprimin e organeve gjatë demonstrimeve publike dhe gjatë pengimit

të çrregullimit të rendit, gjë që gjithashtu ka të bëjë me rrethanat e rastit të shqyrtuar. Gjykata përsërit faktin se roli i mediumeve si "qenë – roje" fiton një rëndësi të veçantë në një kontekst të tillë, meqenëse prezenca e tyre është një garanci se organet mund të jenë përgjegjëse në lidhje me sjelljen e tyre "vis-à-vis" demonstruesve dhe opinionit në tërësi, kur bëhet fjalë për kontrollimin e tubimeve të mëdha, duke i përfshirë edhe metodat të cilat ata i shfrytëzojnë për kontrollimin ose shpërndarjen e demonstruesve ose për ruajtjen e rendit publik. Për këto arsye, çdo orvatje për largimin e gazetarëve nga vendi i demonstrimeve, duhet të jetë lëndë e kontrollimit rigoroz. Kjo edhe më tepër vlen kur gazetarët e realizojnë të drejtën e tyre që tua transmetojnë dhe bartin informacionet opinionit në lidhje me sjelljen e deputetëve të zgjedhur si dhe për mënyrën në të cilën organet po ballafaqohen me rendin e cenuar, që manifestohet gjatë kohës së seancave të kuvendit.

Gjykata i merr parasysh të gjitha rrethanat, para dhe gjatë kohës së debatit kuvendarë, lëndë e këtij shqyrtimi. Në lidhje me këtë, udhëzon për "paralajmërimet" për "protesta dhe incidente", si dhe "indikacione dhe pritje se debati për miratimin e buxhetit do të bëhet tenzionues".

Gjatë çrregullimit të rendit në sallën e kuvendit, ankuesit kanë qenë vrojtues pasiv, të cilët thjeshtë kanë kryer punën e tyre dhe i kanë përcjell ngjarjet. Sipas kësaj, ata nuk kanë paraqitur kurrfarë rreziku mbi sigurinë publike, rendin në sallë ose çfarëdo tjetër.

Gjykata konsideron se nuk ka indikacione se çrregullimi i rendit nga ana e deputetëve në sallë, do ti vinte në rrezik jetën dhe integritetin fizik të ankuesve. Si element i vetëm relevant në të cilin është mbështetur Gjykata kushtetuese gjatë sajimit të konkludimit të saj, është fakti se ankuesit nuk kanë qenë të sigurt dhe se "në sallën e kuvendit janë hedhur gjësende, disa prej tyre në drejtim të galerisë". Prapëseprapë, Gjykata vëren se nuk janë dhënë sqarime plotësuese në lidhje me llojin dhe numrin e gjësendeve të hedhura dhe se vallë cilido prej tyre ka arritur deri në galeri, e cila sikur që është theksuar më lartë, gjendet mbi sallën. Gjykata vëren se "SKBSP" në shkresën e saj nuk ka theksuar se janë hedhur gjësende në sallë. Gjykata më pas thirret në konkluzionin

e lartpërmendur se ankuesit kanë qenë të privuar nga mundësia që ti kontestojnë faktet gjatë seancës dëgjimore, fakte këto mbi të cilat Gjykata kushtetuese ka mbështetur vendin e saj në lidhje me rreziqet e sigurisë për ankuesit.

Në fund, Gjykata vlerëson se palët kanë parashtruar argumente kundërthënëse për atë se vallë ankuesit kanë qenë në gjendje që ti përcjellin ngjarjet në sallë, pas largimit të tyre nga galeria. Gjykata përkujton faktin se në aktgjykimin e miratuar, Gjykata kushtetues ka përcaktuar se gazetarët "kanë qenë në gjendje që ta përcjellin drejtpërdrejtë seancën nga hapësirat tjera (pres qendra, në sallën që gjendet në afërsi të drejtpërdrejtë të galerisë)" dhe se "seanca plenare e kuvendit e datës 24 dhjetor të vitit 2012, ka qenë publike dhe e emetuar drejtpërdrejtë në kanalin televiziv të kuvendit në suaza të Radio televizionit të Maqedonisë si dhe përmes ueb strimingut të faqes së internetit të kuvendit. Pas përfundimit të seancës, video regjistrimi i saj ka qenë i ngjitur dhe në qasje për të gjithë vizitorët e faqes së internetit të Kuvendit.".

Edhe pse Gjykata nuk ka bazë që ti kontestoj këto argumente faktike, të njëjtat si të tilla, sipas mendimit të Gjykatës nuk udhëzojnë në konkludimin se ankuesit kanë pasur mundësinë efektive që të përcjellin largimin e parashikueshëm dhe në rrjedhë të deputetëve të opozitës nga ana e shërbimit për sigurim, gjë që siç është theksuar më lartë, ka qenë çështje e interesit legjitim publik. Më tutje, largimi i ankuesve ka përfshirë efekte të drejtpërdrejta të padëshiruara, të cilat aty për aty i kanë penguar që nga dora e parë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë të furnizohen me informacione në bazë të përvojës së tyre personale për ngjarjet që janë zhvilluar në sallë, me këtë edhe kontekstin e pakufizuar në të cilin organet kanë vepruar me të njëjtit. Këto kanë qenë elemente të rëndësishme për ushtrimin e funksionit të gazetarisë nga ana e ankuesve, prej të cilëve opinioni i gjerë nuk duhet të privohet në rrethanat e rastit konkret.

Edhe pse shkaqet e parapara nga ana e Gjykatës kushtetuese kanë qenë relevante, të njëjtit mund të konsiderohen, nën rrethanat e dhëna, si të mjaftueshme që të arsyetohet largimi i ankuesve nga galeria.

Sipas kësaj, janë evidente shkeljet e nenit 10 të Konventës.

Duke i pasur parasysh faktet e lartpërmendura, GJEDNJ ka konstatuar shkelje të nenit 6 dhe 10 të KEDNJ.

Duke pasur parasysh lartpërmendurën, Gjykata ka gjykuar se shteti i paditur duhet ti paguaj çdonjërit prej ankuesve shumën me nga 5000 euro si dëmshpërblim të dëmit të natyrës jo materiale.

Karajanov kundër RM-së, A. nr. 2229/15**,** aktgjykimi i GJEDNJ i datës 6 prill të vitit 2017.

Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut (GJEDNJ), solli aktgjykimin në lidhje me rastin Karajanov kundër RM-së, A. nr. 2229/15, me të cilin konstatoi shkelje të neneve 6, paragrafi 1 dhe 8 të Konventës.

Përkatësisht, ankesa ka qenë e parashtruar më datën 30 dhjetor të vitit 2014 nga ana e nënshtetasit të Maqedonisë, z. Petar Karajanov ("ankuesi").

Argumentet e Komisionit për verifikim të fakteve (Komisioni i Lustrimit)

Më 27 maj të vitit 2013, Komisioni për verifikim të fakteve ("Komisioni") në procedurën për lustrime ka konstatuar se ankuesi ka bashkëpunuar me Shërbimet e sigurimit shtetërorë. Në pajtim me këtë, komisioni ka vendosur se ankuesi e ka përmbushur kushtin për kufizim të kandidaturës së tij dhe për ushtrimin e funksionit publik.

Duke u thirrur në raportin e regjistruar si dosje me nr. 6825, Komisioni ka konstatuar se në vitin 1963, pas vizitës së vëllait të tij në Suedi, ankuesi Shërbimeve sekrete të sigurimit u ka dhënë informacione në lidhje me vëllain e tij, bashkëshorten e vëllait të tij dhe për persona të tjerë. Gjithashtu, ai ka dhënë informacione edhe për persona të tjerë nga qyteti i Gjevgjelisë.

Në bazë të dosjes tjetër me nr. 2599, Komisioni ka konstatuar se ankuesi, deri sa ka ushtruar detyrën e redaktorit kryesorë dhe përgjegjës të gazetës,

në vitin 1962 dhe më vonë u ka dhënë informacione shërbimeve sekrete të sigurisë për kolegun e tij, për artikujt që i ka shkruar kolegu i tij si dhe informacione në lidhje me raportet e tij me njerëzit tjerë.

Aktvendimi i Komisionit ka qenë i publikuar në faqen e internetit të komisionit më 30 maj të vitit 2013. I njëjti ka përfshirë informacione për vendin e lindjes së ankuesit, numrin e tij të amzës si dhe funksionet që i ka ushtruar më parë. Aktvendimi i është dorëzuar ankuesit më datën 4 qershor të vitit 2013.

Procedura para Gjykatës administrative

Më 11 qershor të vitit 2013, ankuesi ka kontestuar vendimin e Komisionit para Gjykatës administrative, duke pohuar se argumentet e Komisionit, në bazë të dosjes me nr. 6825 kanë qenë të gabuara, meqenëse dukshëm dosja i është dedikuar një personi tjetër me emër të njëjtë, dhe jo për të. Ai ka parashtruar disa dokumente që të dëshmoj se vendimi për lustrim ka qenë si rezultat i identitetit të përcaktuar në mënyrë të gabuar (certifikata nga libri i amzës së personave të lindur, që ka treguar datën e lindjes që dallohet nga data e regjistruar në dosjen me nr. 6825); aktvendimin për trashëgimi me të cilin dëshmohet se ankuesi ka pasur motrën në vend të vëllait të cekur; librezën e tij të ushtrisë, që dëshmon se në vitin 1963 ai ka shërbyer shërbimin ushtarak në Bosnje dhe Hercegovinë; si dhe certifikatën e vdekjes që dëshmon se babai i tij ka ndërruar jetën në vitin 1962. Ankuesi ka pohuar se asnjëherë nuk ka qenë në Suedi dhe se nga viti 1955 ai ka jetuar në Shkup. Ai gjithashtu, e ka kontestuar saktësinë dhe besueshmërinë e dokumenteve të përfshira në dosjen me nr. 2599 dhe ka mohuar se ndonjëherë ka bashkëpunuar me shërbimet sekrete të sigurisë, dhe se ai nuk ka përcjell kurrfarë informacione për cilindo prej kolegëve të tij deri te shërbimet e sigurisë shtetërore. Në lidhje me këtë, ankuesi ka theksuar se asnjë dokument i përfshirë në dosjen nuk është nënshkruar nga ana e tij. Në të njëjtën kohë, ai ka theksuar se autoriteti i tij, dinjiteti, të dhënat personale dhe integriteti i tij janë vënë në pyetje.

Në seancën e mbyllur të mbajtur më 29 janar të vitit 2014., Gjykata administrative ka refuzuar kërkesën e ankuesit. Gjykata ka konstatuar se

Komisioni në mënyrë të rregullt i ka konstatuar faktet dhe se ka zbatuar ligjin përkatës në këtë rast.

Më 7 mars të vitit 2014, ankuesi ka parashtruar ankesën para Gjykatës së Lartë Administrative. Ai i ka përsëritur argumentet ankuese të iniciuara në padinë e tij deri te Gjykata Administrative dhe ka theksuar se kjo gjykatë nuk ka dhënë kurrfarë arsyetimi në lidhje me ankesën e tij, se me shpalljen e Aktvendimit të Komisionit në ueb faqen e tij të internetit është shkelur e drejta e tij për respektim të jetës së tij private dhe familjare, autoriteti dhe dinjiteti i tij. Sipas tij, gjithashtu janë hedhur poshtë dëshmitë e tij se skedari me nr. 6825 nuk ka qenë në lidhje me të, por se ky skedar ka qenë i dedikuar për një person tjetër me emër të njëjtë, gjë që ka rezultuar me përcaktim të gabuar të gjendjes faktike. Ai ka deklaruar se gjykata, gjithashtu, është mbështetur mbi dëshmitë e parashtruara nga ana e Komisionit. Njëherit, ai është ankuar për mungesën e seancës dëgjimore para Gjykatës administrative, duke i theksuar arsyetimet e dhëna se nuk ekziston dispozitë ligjore e cila do ti lejojë atij që të kërkoj një seancë të tillë. Në fund, ai ka kontestuar arsyetimet e dhëna nga Gjykata administrative për mjetet e mundshme juridike, të cilat ai do të mund ti shfrytëzonte që ta kontestoj besueshmërinë e dokumenteve të përfshira në dosjen me nr. 2599.

Më 12 qershor të vitit 2014, Gjykata e lartë administrative e ka refuzuar ankesën e ankuesit dhe ka konfirmuar vendimin e miratuar nga gjykata e instancës më të ulët. Kjo gjykatë nuk ka gjetur bazë për anulimin e fakteve, në pajtim me faktet e konstatuara, e as anulimin e sqarimeve e dhëna nga ana e Komisionit dhe nga ana e Gjykatës administrative.

Aspektet e qëndrueshmërisë

Parashtresat e palëve

Ankuesi është ankuar se procedura për lustrim ka qenë e padrejtë.

Sipas Qeverisë, procedura e lustrimit në lidhe me ankuesin ka qenë në pajtim me kërkesat e nenit 6 të Konventës. Ankuesi nuk i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet e disponueshme të procedurës administrative që ti kontestoj

argumentet fillestare të Komisionit. Ashtu siç është theksuar nga ana e Gjykatës administrative, çfarëdo lloj i çështjeve lidhur me besueshmërinë e informacioneve të përfshira në dosjen e tij, është dashur që të zgjidhen në një procedurë të posaçme para gjykatës kompetente "para se të miratohet aktvendimi i kontestuar". Qeveria, gjithashtu ka theksuar se ankuesi nuk ka kërkuar seancë dëgjimore. Në fund, Qeveria ka theksuar se gjykata ka siguruar shkaqe të mjaftueshme për miratimin e vendimeve të saja.

Vlerësimi i Gjykatës

Parimet themelore

Gjykata konsideron se në rastet sikur rasti i shqyrtuar, kur ankuesi ankohet për padrejtësi të procedurës dhe i mbështet argumentet e vete me disa argumente të cilat mes vete plotësohen dhe përputhen për nga aspekti i nenit 6, paragrafi 1 të Konventës, qasja përkatëse është shqyrtimi i aspektit të drejtësisë së procedurave marrë si një tërësi e vetme.

Në këtë kuptim, Gjykata vëren se edhe pse neni 6 e garanton të drejtën e gjykimit të drejtë, ai nuk parashikon kurrfarë rregulla për nga aspekti i lejueshmërisë së dëshmive ose për mënyrën në të cilën të njëjtit duhet të vlerësohen, të cilët nga ana tjetër dhe para se gjithash janë çështje që kanë të bëjnë me rregullimin e së drejtës vendore dhe me gjykatat vendore.

Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se Konventa është përcaktuar për garantimin, jo të drejtave të cilat janë iluzore ose të natyrës teorike, por për të drejtat që janë praktike dhe efektive, e drejta e gjykimit të drejtë nuk mund të kuptohet si efektive, me përjashtim të rasteve nëse kërkesat dhe vërejtjet e palëve janë me të vërtetë "të dëgjuara", përkatësisht, mirë të shqyrtuara dhe të hulumtuara nga ana e gjykatës.

Gjykata, gjithashtu thekson se në procedurat para gjykatës së nivelit të parë dhe të vetëm, e drejta për "debat publik" e sajon të drejtën e "seancës dëgjimore" në pajtim me nenin 6§1, me përjashtim të rasteve kur ekzistojnë rrethana përjashtuese të cilat e arsyetojnë anulimin e një debati të tillë.

Dhe në fund, sipas praktikës së themeluar gjyqësore të Gjykatës, që reflekton parimin lidhur me zbatimin e rregullt të drejtësisë, aktgjykimet e gjykatave dhe të tribunaleve, në mënyrë përkatëse duhet ti theksojnë shkaqet në bazë të cilave mbështeten. Niveli deri në të cilin zbatohet ky detyrim i dhënies së arsyetimit, mund të manifeston variacione në varësi të natyrës së vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit përkatës.

E drejta e ankuesit, që në mënyrë efektive të prezantoj rastin e tij

Gjykata, thekson se ankuesi nuk ka qenë i involvuar në procedurën para Komisionit dhe në mënyrë përkatëse ai nuk ka qenë të gjendje që ti prezantoj argumentet e mbrojtjes së tij. Në aktvendimin e datës 12 qershor të vitit 2014, Gjykata e lartë administrative konsideron se "nuk ekziston procedura kontradiktore para Komisionit".

Gjykatat administrative i kanë pranuar faktet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe arsyet e theksuara në aktvendimin e tij. Ata e kanë refuzuar argumentin e parë të ankuesit, duke konsideruar se Komisioni e ka identifikuar atë në aktvendimin e tij përmes thirrjes së numrit të vetëm të amzës për identifikim, në bazë të vendit të tij të lindjes dhe në bazë të funksioneve që ai i ka ushtruar gjatë regjimit të mëparshëm. Gjykata vëren se nga arsyetimet e dhëna nga gjykatat administrative, me lehtësi nuk mund të sajohet konkludimi se deri në cilin nivel gjykatat në mënyrë esenciale i kanë hulumtuar regjistrat faktike lidhur me ankuesin, të cilët janë ruajtur nga ana e shërbimeve sekrete, ose ajo që është edhe më me rëndësi, nuk janë hulumtuar dëshmitë e ofruara nga vetë ankuesi. Në këto rrethana, neni 6 i Konventës, nga gjykatat vendore kërkon që të sigurojnë sqarime më esenciale për shkaqet e tyre, në vend të asaj që ata thjeshtë të thonë se (ankuesi) nuk ka parashtruar asnjë dëshmi që do të rezultonte me fakte të ndryshme". Argumenti i dytë i ankuesit, në lidhje me besueshmërinë e dëshmive nga dosja me nr. 2599, ka qenë i refuzuar me arsyetimin se ai: "ka mundur të inicioj procedurën para gjykatës kompetente për përcaktimin e saktësisë të tyre...". Gjykata vëren se gjykata administrative nuk ka precizuar se çfarë lloj të procedurës ka mundur që të inicioj ankuesi. Më tutje, gjykata e konsideron si vështirë të pranueshëm faktin se ai është dashur që ta inicioj këtë procedurë "para miratimit të

aktvendimit të kontestuar (të Komisionit)". Në lidhje me këtë, asgjë nuk dëshmon se ankuesi ka qenë i vetëdijshëm për faktin se shërbimet sekrete nga regjimi i mëparshëm kanë pasur çfarëdo lloj të informacioneve në lidhje me të, para se atij ti dorëzohet aktvendimi nga ana e Komisionit më datën 4 qershor të vitit 2013.

Gjykata konsideron se gjendja e tillë ka qenë e dëmshme për nga aspekti i realizimit efektiv të prezantimit të rastit të tij nga ana e ankuesit, në suaza të kuptimit të nenit 6, paragrafi 1 të Konventës.

E drejta e seancës dëgjimore

Gjykata më pas vëren se nuk ka pasur seancë dëgjimore në prani të ankuesit, në cilindo prej fazave të procedurës së kontestuar. Edhe pse është e vërtetë se ai nuk ka kërkuar një lloj të debatit të tillë para Gjykatës administrative, gjithashtu duhet të theksohet fakti se Ligji për kontestet administrative, i cili ka qenë në fuqi në periudhën relevante kohore, nuk parashikon mundësinë e tillë.

Duke pasur parasysh lartpërmendurën, Gjykata nuk fiton bindjen se kanë ekzistuar rrethana përjashtuese të cilat do të arsyetonin mos mbajtjen e seancës dëgjimore.

Aktgjykimi i arsyetuar

Në, fund, pohimet e ankuesit se bashkëpunimi i cekur nuk ka përmbushur kriterin cilësorë, të cekur në Ligjin për lustrim, ka qenë vendimtare për rezultatet e këtij rasti si dhe për shkak të kësaj është kërkuar përgjigje më specifike. Kjo është kështu, për shkak të faktit se bashkëpunimi i cili nuk ka qenë "i vetëdijshëm, sekret, i organizuar dhe i vazhdueshëm", nuk ka mundur që ti shërbej qëllimeve të lustrimit. Një element tjetër është fakti se bashkëpunëtori ose informatori është dashur "si shpërblim (për bashkëpunimin e tillë) të përfitoj leverdi materiale ose dobi gjatë kohës së punësimit ose të përfitoj avancime". Gjykata nuk mund të pranoj faktin se vetëm citimi i këtyre kritereve, pa theksimin e fakteve konkrete në drejtim të

argumentimit të bashkëpunimit të cekur me të njëjtit, nënkupton përgjigjen e mjaftueshme në lidhje me parashtresat e ankuesit.

Në rrethana të tilla, Gjykata konsideron se gjykatat vendore nuk kanë arritur që ta ushtrojnë detyrën e tyre në pajtim me nenin 6, paragrafi 1 të Konventës, përkatësisht nuk kanë mundur që të ofrojnë shkaqe të mjaftueshme për vendimet e tyre, dhe për këtë arsye, Gjykata konsideron se ekzistojnë shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë të ankuesit, në kuptim të nenit 6, paragrafi 1 të Konventës.

SHKELJA E CEKUR E NENIT 8 KONVENTËS

Ankuesi është ankuar se shpallja e aktvendimit në faqen e internetit të Komisionit më datën 27 maj të vitit 2013, para hyrjes në fuqi të aktvendimit, ka shkaktuar efekte serioze negative mbi autoritetin e tij, dinjitetin dhe integritetin moral të tij dhe e ka cenuar të drejtën e tij për respektimin e jetës private dhe familjare, në pajtim me nenin 8 të Konventës.

Aspekti i qëndrueshmërisë

Parashtresat e palëve

Ankuesi ka theksuar se shpallja e aktvendimit në faqen e internetit të Komisionit, para hyrjes në fuqi është në kundërshtim me ligjin dhe se një masë e tillë nuk është e domosdoshme në një shoqëri demokratike.

Qeveria ka theksuar se shpallja e kontestuar e aktvendimit të Komisionit, nuk i ka shkelur të drejtat e ankuesit, të theksuara në nenin 8, meqenëse ai nuk ka qenë i penguar që ta kontestoj këtë aktvendim para gjykatave administrative. Ata janë thirrur në rastet në të cilat vendimet e tilla kanë qenë të mënjanuara nga faqja e internetit të Komisionit, pasi që janë anuluar nga ana e gjykatave administrative. Dhe në fund, qeveria ka theksuar se shpallja e kontestuar e vendimit, ka pasur për qëllim që të sigurohet një transparencë më e madhe, duke u mundësuar në këtë mënyrë, palëve që

janë të përfshira në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë rast si dhe opinionit më të gjerë, qasje deri te dëshmitë relevante. Me këtë janë përmirësuar edhe mundësitë që bashkëpunëtorët e shqyrtuar të jenë në gjendje që ti kontestojnë vendimet e Komisionit në procedurat përkatëse gjyqësore. Një veprim i tillë, gjithashtu ka pasur për qëllim që të pengoj çfarëdo lloj veprimi të vetë vullnetshëm gjatë sjelljes së vendimeve nga ana e Komisionit.

Vlerësimi i Gjykatës

Ligjshmëria

Gjykata vëren se në pajtim me nenin 29, paragrafi 2 dhe nenit 31 paragrafi 1 të Ligjit për lustrim, parashikohet që aktvendimi i Komisionit për lustrim, menjëherë duhet të shpallet në faqen e internetit të Komisionit, por më vonë tre ditë nga dita e përfundimit të procedurës ose nga dita e dorëzimit deri te personi i përfshirë. Në rrethana të tilla, shpallja e aktvendimit të Komisionit më 30 maj të vitit 2013 ka qenë e mbështetur në dispozitat relevante të Ligjit për lustrim, që i ka përmbushur kërkesat cilësore për qasje dhe parashikueshmëri. Për këtë arsye, Gjykata është e bindur se involvimi në jetën private të ankuesit, ka qenë në pajtim me ligjin, sipas nenit 8, paragrafi 2 të Konventës.

Qëllimi legjitim

Gjykata tani më ka konstatuar se për masat e lustrimit, duhet të supozohet se pasojnë qëllime legjitime për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, sigurisë publike, mirëqenies ekonomike të shtetit, si dhe të drejtat dhe liritë e personave të tjerë.

Prapëseprapë, hulumtimi i tyre në këtë kuptim, duhet të kufizohet me ankesën e ankuesit, që nuk ka të bëjë me rezultatet e procedurës për lustrimin kundër tij, por kanë të bëjnë me faktin se aktvendimi i Komisionit për bashkëpunimin e tij me shërbimet e sigurisë së regjimit të mëparshëm, ka qenë i shpallur para hyrjes në fuqi të këtij aktvendimi.

Qeveria ka konsideruar se shpallja e informacioneve të tilla siguron një transparencë më të madhe, një qasje publike deri te dokumentet e përfshira në dosjen e ankuesit si dhe kontrollim publik të procesit të sjelljes së vendimeve të Komisionit. Gjykata nuk konsideron se, cilido prej qëllimeve të lartpërmendura mund të përfshihet në cilindo prej qëllimeve të cekura në nenin 8, paragrafi 2 të Konventës. Më pas, Gjykata nuk mund të gjej se si shpallja para opinionit dhe ofrimi në qasje i aktvendimit të Komisionit i cili akoma nuk ka hyrë në fuqi, mund të harmonizohet me qëllimet e përgjithshme të lustrimit, të cilat Gjykata i pranoi si legjitime.

Në lidhje me këtë, duhet të theksohet se ankuesi ka pasur shtatëdhjeteshtatë vite kur Komisioni ka sjell aktvendimin e tij dhe ai nuk ka ushtruar funksione publike. Më pas, në procedurat vendore ose para Gjykatës nuk është theksuar se ai ka qenë kandidat i ndonjë funksioni publik në atë kohë. Gjykata konsideron se duhet të theksohet fakti se Komisioni i Venedikut në raportin e tij "amicus curiae" në lidhje me Ligjin për lustrim të vitit 2012, po ashtu shprehu mendimin se shpallja e rezultateve të Komisionit për lustrim, para shqyrtimit të tyre nga ana e gjykatës, nuk është në pajtim me nenin 8 të Konventës.

Gjykata konsideron se mungesa e qëllimit legjitim, mjafton që të sajohen shkelje të nenit 8. Përskaj kësaj, ky fakt nënkupton se nuk duhet që të përcaktohet se vallë masat e kontestuara kanë qenë "të domosdoshme në një shoqëri demokratike".

Si rezultat i lartpërmendurës, Gjykata konstaton shkelje të nenit 8 të Konventës.

Duke i pasur parasysh faktet e lartpërmendura, GJEDNJ konstaton shkelje të nenit 6 dhe të nenit 8 të KEDNJ.

Në pajtim me konstatimet e tilla, Gjykata ka miratuar aktgjykimin se shteti i paditur, ankuesit duhet ti paguaj shumën prej 4500 euro si dëmshpërblim të dëmit të natyrës jo materiale, dhe shumën prej 1000 euro në llogarinë e bankës së përfaqësuesit ligjorë të ankuesit.

IRZ

Makavej, 2017